

Dokument për politikat publike

“Implementimi i Strategjisë për Reformë të Sektorit të Jurisprudencës në vitit 2017 – 2022”

Ky dokument i shkurtër për politikën publike bazohet në qëndrimet e prezantuara në dialogun për politika publike, i cili u mbajt më 11 dhjetor të vitit 2019 në hotel Arka në Shkup, në kuadër të Projektit “Partneriteti Justitia: Rikthimi i besimit të qytetarëve”, të cilin e implementon Instituti për Politikë Evropiane dhe Asociacioni ZENIT, ndërsa financohet nga Bashkimi Evropian përmes Sektorit për financim qendror dhe lidhje të marrëveshjeve dhe i bashkë-financuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Projekti ka për qëllim të kontribuoj në rikthimin e besimit të qytetarëve në Sektorin maqedonas të jurisprudencës, përmes përfshirjes të konsiderueshme të shoqërisë civile në reformat thelbësore. Përfituesit e fundit të këtij Projekti janë institucionet nga fusha e jurisprudencës.

Dialogu përbëhet nga dy sesione në të cilët morën pjesë rreth 60 përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, Këshilli Gjyqësor, Këshilli i Prokurorëve Publik, gjyqtarë, prokurorë publik, ekspertë të fushës, përfaqësues të sektorit qytetarë dhe përfaqësues të përfaqësive diplomatike në Republikën e Maqedonisë së Veriut.



Projekti është financuar nga
Bashkimi Evropian

Partnership Justitia: Regaining Citizens' Trust
Партнерство Јуститија: Враќање на довербата на граѓаните
Partneriteti Justitia: Rikthimi i besimit të qytetarëve



Projekti është bashkëfinancuar
nga Qeveria e Republikës së
Maqedonisë së Veriut

Përmbajtja

Lista e akronimeve	3
Sesioni 1: Reformat në jurisprudencë	4
Rekomandime:	9
Sesioni 2: Legjislacioni i të drejtës – penale, i të drejtës – civile dhe ndërmjetësimi	10
Rekomandime	14
ANEKSI 1	18
ANEKSI 2	28
ANEKSI 3	29

Ky dokument u hartua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Përmbajtja e këtij dokumenti është në përgjegjësi ekskluzive të autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i përfaqëson qëndrimet e Bashkimit Evropian ose të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.



Projekti është financuar nga
Bashkimi Evropian

Partnership Justitia: Regaining Citizens' Trust
Партнерство Јуститија: Враќање на довербата на граѓаните
Partneriteti Justitia: Rikthimi i besimit të qytetarëve



Projekti është bashkëfinancuar
nga Qeveria e Republikës së
Maqedonisë së Veriut

Lista e akronimeve

SEREJ – Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë

BE – Bashkimi Evropian

PTHP – Prokuroria Themelore Publike

RMV – Republika e Maqedonisë së Veriut

SPB – Sektori për Punë të Brendshme

PSP – Prokuroria Speciale Publike; Prokuroria Publike për Ndjekjen e Veprave Penale

Strategjia – Strategjia për Reforma në Sektorin e Jurisprudencës për vitin 2017 – 2022 me Plan Veprim

QPS – Qendra për Punë Social



Projekti është financuar nga
Bashkimi Evropian

Partnership Justitia: Regaining Citizens' Trust
Партнерство Јустисија: Враќање на довербата на граѓаните
Partneriteti Justitia: Rikthimi i besimit të qytetarëve



Projekti është bashkëfinancuar
nga Qeveria e Republikës së
Maqedonisë së Veriut

Sesioni 1: Reformat në jurisprudencë

Sesioni i parë iu dedikua reformave në jurisprudencë në të cilin mori pjesë ministrja e Drejtësisë, Renata Deskoska; kryetari i Këshillit Gjyqësor, Kiro Zdravev dhe kryetari i Këshillit të Prokurorëve Publik, Aco Kolevski. Konferencën e hapi Ardita Abazi Imeri, koordinatore e programit të Institutit për Politikë Evropiane dhe zëvendës drejtoreshë e Institutit për Politikë Evropiane.

Dr. Abazi Imeri, fillimisht ju dëshiroj mirëseardhje të gjithë të pranishëmve dhe i potencoi produktet kryesore të projektit “Partneriteti Justitia: Rikthimi i besimit të qytetarëve”, të cilin Instituti për Politikë Evropiane e zbaton me Asociacionin ZENIT. Ajo vuri në dukje se ngjarja e sotme ishte parashikuar si një dialog për politika, në mënyrë që sfidat të mund të identifikohen lirisht mes vete dhe të ofrohen zgjidhje dhe rekomandime përkatëse për reformat në sektorin e jurisprudencës dhe përmirësimin e kualitetit të drejtësisë. Reformat në sektorin e jurisprudencës janë me rëndësi të jashtëzakonshme për fuqizimin e sistemit dhe në këtë mënyrë për rikthimin e besimit të qytetarëve në jurisprudencë, e cila gjatë viteve të kaluara shënon rënie.

Ministrja e Drejtësisë Prof. Dr. Renata Deskoska i prezantoi të gjitha reformat që u realizuan në sektorin e jurisprudencës nga viti 2017. Reformat në pjesën e jurisprudencës janë të dukshme, veçanërisht nëse merret parasysh fakti se ku gjendej shteti ynë në këtë fushë. Reformat kryesore filluan me miratimin e Strategjisë për Reforma në Sektorin e Jurisprudencës 2017 – 2022 me Plan Veprimin (Strategjia). Strategjia, në fillim ishte tejet ambicioze nga aspekti i afateve të cilat i parashikonte për reforma të caktuara dhe zgjidhje të caktuara për afatet për implementimin e Strategjisë. Në këtë drejtim ndryshoi Plan Veprimi me qëllim që të jepet korniza e vërtetë kohore dhe hapësira për debat gjithëpërfshirës për zgjidhje të caktuara të cilat propozohen dhe të cilat ndërmerren, meqë një pjesë e madhe e ligjeve të cilat miratohen në fushën e jurisprudencës, janë ligje të cilët miratohen me dy të tretën dhe ligje sistematikë për të cilët nevojitet të lihet një proces i konsultimeve, me qëllim që të zgjidhen zgjidhjet më të mira. Në mënyrë plotësuese, reformat e jurisprudencës janë komplekse meqë kërkojnë angazhim dhe veprim nga të tre pushtetet e shtetit, pushteti ekzekutiv i cili i përgatitë politikat, Kuvendi i cili i miraton ligjet dhe gjyqësori i cili duhet t’i implementojë në mënyrë përkatëse këto ligje.¹

Gjatë dy viteve të fundit u realizuan aktivitetet më të mëdha reformatore në pjesën e jurisprudencës.²

Në këtë drejtim u miratua Ligji për gjykatat, në një procedurë inkluzive të përgatitjes së të njëjtit, i cili u aprovua nga Komisioni i Venecias.³

¹Prof. Dr. Renata Deskoska, ministre e Drejtësisë

²Prof. Dr. Renata Deskoska, ministre e Drejtësisë

³Prof. Dr. Renata Deskoska, ministre e Drejtësisë

Partnership Justitia: Regaining Citizens’ Trust

Партнерство Јуститија: Враќање на довербата на граѓаните
Partneriteti Justitia: Rikthimi i besimit të qytetarëve



U miratua Ligj tërësisht i ri për Këshillin Gjyqësor.⁴ Me Ligjin e ri për Këshillin Gjyqësor⁵ u përmirësua llogaridhënia dhe transparenca e Këshillit Gjyqësor. Një hap përpara u bë edhe me atë që në përgjithësi mbledhjet e Këshillit Gjyqësor janë publike, publiku sa i përket diskutimit në mbledhjet e Këshillit Gjyqësor, mund të përjashtohet vetëm nëse përmbushen supozimet ligjore, ndërsa kjo ndodh në raste kur bëhet fjalë për mbrojtjen e personalitetit dhe integritetit të vet gjyqtarit, por edhe në këto raste, kryetari i Këshillit Gjyqësor duhet të jep arsyetim se pse është përjashtuar publiku. Përveç kësaj, gjatë për zgjedhjes së gjyqtarëve secili anëtar i Këshillit Gjyqësor e ka për detyrë ta mbroj vendimin e vet, se pse ka votuar për gjyqtarin e caktuar dhe të jep arsye të justifikueshme për këtë.⁶

Ekzistojnë mospajtime nga kasta e gjyqtarëve në lidhje me strukturën organizative të Këshillit dhe diskriminimin sa i përket zgjedhjes së anëtarit të Këshillit nga radha e gjyqtarëve dhe të anëtarëve të cilët zgjidhen nga Kuvendi.⁷ Sa i përket strukturës organizative, kasti i gjyqtarëve ka vërejtje lidhur me dispozitën e ligjit sipas së cilës, kryetari i Këshillit Gjyqësor zgjidhet nga anëtarët të cilët janë zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, meqë Këshilli Gjyqësor e ka për detyrë të siguroj dhe e garantoj pavarësinë dhe autonominë e pushtetit gjyqësor, që është përcaktuar në Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Qëndrimet shkojnë në drejtim të asaj se kjo mënyrë e zgjedhjes së kryetarit të Këshillit megjithatë përmes kapixhikut e fut politikën në Këshillin Gjyqësor. Ekziston edhe diskriminim në lidhje me rizgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor. Sipas kësaj, anëtarët e Këshillit Gjyqësor nga radha e gjyqtarëve, nuk kanë të drejtë për rizgjedhje, përkatësisht duhet të kalojnë gjashtë vjet pas përfundimit të mandatit që sërish të zgjidhen, ndërsa anëtarët e Këshillit Gjyqësor nga radha e anëtarëve të cilët i zgjedh Kuvendi, ata kanë mundësi të zgjidhen dy herë radhazi për anëtarë të Këshillit Gjyqësor.⁸

Sa i përket implementimit, Këshilli Gjyqësor ballafaqohet me “obstruksion legal” nga pushteti ligjvënës. Para tre muajsh u skadoi mandati dy përfaqësuesve të Këshillit Gjyqësor, megjithatë procedura e zgjedhjes në Kuvend akoma nuk ka përfunduar. I skadoi mandati edhe një anëtar i Këshillit Gjyqësor, ndërsa në fillim të vitit 2020 i skadon mandati edhe një anëtar i Këshillit Gjyqësor. Për shkak të mospasjes së kuorumit Këshilli Gjyqësor nuk do të ketë mundësi t’i kryej kompetencat e tij themelore, përkatësisht të zgjedh dhe shkarkoj gjyqtarë. Në këtë drejtim, nevojitet sa më shpejtë të zgjidhen dy anëtarë të Këshillit Gjyqësor nga ana e Kuvendit.⁹

Edhe pse është e mirë dispozita e përcaktuar në Ligjin për Këshillin Gjyqësor¹⁰ e cila e mundësoi zgjerimin e të drejtës së qasjes deri te Këshilli Gjyqësor kështu që çdo qytetar të ketë mundësi të parashtoj kërkesë për konstatimin e përgjegjësisë së gjyqtarit, megjithatë angazhimi i

⁴Prof. Dr. Renata Deskoska, ministre e Drejtësisë

⁵Kiro Zdravev, kryetar i Këshillit Gjyqësor të RMV

⁶Kiro Zdravev, kryetar i Këshillit Gjyqësor të RMV

⁷Kiro Zdravev, kryetar i Këshillit Gjyqësor të RMV

⁸Ibid.

⁹Ibid.

¹⁰Ibid.



Këshillit Gjyqësor në këtë segment të kompetencës së tij është i madh dhe ekziston rreziku në ndonjë mënyrë të mos u përgjigjet kompetencave të tjera të Këshillit Gjyqësor të parashikuara me ligj.¹¹

Me qëllim të implementimit konsekuent të Ligjit të ri për Këshillin Gjyqësor, Këshilli Gjyqësor filloi me implementimin e disa projekteve. Në kuadër të projektit “Ofrimi i ndihmës në jurisprudencën e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, i cili është në kuadër të Programit IPA të Bashkimit Evropian, Këshilli Gjyqësor e harton Rregulloren dhe aktet e tjera nënligjore, të cilat janë parashikuar me Ligjin për Këshillin Gjyqësor, përfshirë këtu edhe Rregulloren për përcaktimin e rank listës së kandidatëve për zgjedhjen e gjyqtarëve në gjykatat e shkallës së parë. Sipas ligjit të vjetër këtë rank listë e përcaktonte Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë.¹² Nevojitet të rritet numri i gjyqtarëve.¹³ Në këtë drejtim, nevojitet edhe përforsimi i kapaciteteve të Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë për të pranuar kandidatë të ri në trajnimin fillestar.

Në realizim e sipër është edhe projekti për hartimin e Metodologjisë me indikatorë të kompleksitetit të lëndëve dhe Rregullore të posaçme për evaluim përkatësisht për notimin e gjyqtarëve. Kjo Metodologji është e një rëndësie jashtëzakonisht të madhe, si sa i përket konfirmimit të vendimit me të cilin do të përcaktohet norma e përafërt të cilën në nivel mujor duhet ta përmbushin gjyqtarët, ndërsa nga ana tjetër nga e njëjta varen edhe aktivitetet e mëtutjeshme të Këshillit Gjyqësor, në kuptimin e rishikimit të rregulloreve për sistematizimin e vendeve të punës, përkatësisht të numrit të nevojshëm të gjyqtarëve dhe të nëpunësve gjyqësorë nëpër gjykata. Kjo Rregullore ka një rëndësi të madhe për evaluimin e gjykatave dhe të gjyqtarëve, të cilët do të evaluohen sipas kriterëve reale dhe objektive, duke e marrë parasysh kompleksitetin e lëndëve.¹⁴ Në Ligjin e ri për Këshillin Gjyqësor është parashikuar¹⁵ që notimin ta bëjnë vet gjyqtarët, ndërsa Këshilli Gjyqësor në një farë mënyre do t’i sublimoj rezultatet.¹⁶ Prandaj do të ishte e udhës për hartimin e Rregullores për notimin e gjyqtarëve, të gjithë gjyqtarët dhe gjykatat e shtetit ta japin kontributin e tyre.¹⁷

¹¹Kryetari i Këshillit Gjyqësor të RMV theksoi se në vitin 2017 deri te Këshilli Gjyqësor janë parashtruar kërkesa për konstatimin e përgjegjësisë kundër 17 gjyqtarëve; në vitin 2018 u parashtruan kërkesa për konstatimin e përgjegjësisë kundër 10 gjyqtarëve, në vitin 2019 përfundimisht më datë 11 dhjetor janë parashtruar kërkesa për konstatimin e përgjegjësisë kundër 65 gjyqtarëve.

¹²Ibid.

¹³Për momentin në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka 506 gjyqtarë, ndërsa sipas sistematizimit duhet të ketë 639 gjyqtarë.

¹⁴Kiro Zdravev, kryetar i Këshillit Gjyqësor të RMV

¹⁵Në përputhje me nenin 81, paragrafin 3 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor parashikohet që për përcaktimin e përmbushjes së kriterëve kualitativë për notimin e punës së gjyqtarit ta bëjnë komisione të përbëra me nga pesë anëtarë nga gjykatat e apelit të shtetit, përkatësisht nga gjykata e drejtpërdrejt më e lartë.

¹⁶Kiro Zdravev, kryetar i Këshillit Gjyqësor të RMV

¹⁷Olja Ristova, gjyqtare dhe Kiro Zdravev, Kryetar i Këshillit Gjyqësor

Partnership Justitia: Regaining Citizens’ Trust

Партнерство Јуститија: Враќање на довербата на граѓаните
Partneriteti Justitia: Rikthimi i besimit të qytetarëve



Me Ligjin e ri për konteste administrative i cili do të zbatohet nga muaji maj i vitit 2020, parashikohen më shumë obligime për gjyqësorin administrativ. Përkatësisht, Gjykata Administrative do të jetë në rankun e gjykatave të tjera përmes zhvillimit të seancave publike para të njëjtës.¹⁸ Megjithatë, nevojitet ekipim kadrovik dhe sigurim të kushteve përkatëse hapësinore për gjyqësorin administrativ, veçanërisht duke i pasur parasysh zgjidhjet e reja të parashikuara me ligjin e ri.¹⁹ Ka filluar procedura për sigurimin e objektit të ri në të cilin do të vendoset Gjykata Administrative.²⁰

U miratua Ligji i ri për kundërvajtje²¹ dhe për momentin bëhen harmonizime të ligjeve të tjerë me këtë ligj i cili miratohet me dy të tretën nga numri i përgjithshëm i deputetëve. Ndryshime janë bërë sa i përket ekzekutimit të cilat duhet të mundësojnë drejtësi sociale, ndërsa në pjesën e noterisë janë suspenduar taksat gjyqësore për procedura të caktuara. Në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë është hartuar propozim Ligj i ri për Akademinë e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, i cili aktualisht është në procedurë parlamentare, megjithatë ky Ligj është bllokuar nga opozita me paraqitjen e mbi nëntëqind amendamenteve. U miratua edhe Ligji i ri për ndihmë juridike falas me të cilin zgjerohet rrethi i personave të cilët mund të kërkojnë ndihmë juridike falas. Ministria e Drejtësisë përgatiti edhe propozim ligje të reja, përkatësisht propozim – Ligjin për menaxhimin me lëvizjen e lëndëve nëpër gjykata, Propozim – Ligjin për të drejtën ndërkombëtare private, Propozim - Ligjin për procedurë penale, Propozim – Ligjin për pagesën e kompensimit në para viktimave të veprave të dhunshme penale dhe në rrjedhë e sipër është hartimi i Ligjit të ri për drejtësinë e fëmijëve. Në fushën e të drejtës civile në rrjedhë e sipër është hartimi i Draft – Ligjit për marrëdhënie detyrimore, ministria e Drejtësisë theksoi se në këtë pjesë presin një proces të gjatë inkluziv të debateve për këto ndryshime meqë bëhet fjalë për një ligj themeltarë i cili i rregullon marrëdhëniet e përditshme të qytetarëve. Në fushën e të drejtës procesuale civile në rrjedhë e sipër është formimi i grupit të punës për ndryshimin e Ligjit për procedurë kontestimore.²²

Krahas hartimit të Ligjit të ri për Prokurorinë Publike, në Kuvend akoma nuk ka konsensus për miratimin e këtij ligji.²³ Me këtë Ligj, mes tjerash, rregullohet edhe transferimi i lëndëve nga Prokuroria Speciale Publike në Prokurorinë e Rregullt. Ministria theksoi se problem paraqesin dispozitat kalimtare, të cilat duhet ta rregullojnë kalimin e të gjitha procedurave nga PSP në Prokurorinë e Rregullt Publike.²⁴ Duhet të ruhen praktikat e mira të cilat i vendosi Prokuroria Themelore Publike gjatë punës së vet nga aspekti i resurseve njerëzore edhe në Prokurorinë Publike për Ndjekjen e Krimit dhe Korrupsionit të Organizuar, para së gjithash duke e marrë parasysh se deri në këtë moment kjo Prokurori nuk pësoi kurrfarë ndryshime dhe as reforma.²⁵ Si

¹⁸Prof. Dr. Renata Deskoska, ministre e Drejtësisë

¹⁹Lidija Kanačkoviq, gjyqtare në Gjykatën e Lartë Administrative,

²⁰Prof. Dr. Renata Deskoska, ministre e Drejtësisë

²¹Prof. Dr. Renata Deskoska, ministre e Drejtësisë

²²Prof. Dr. Renata Deskoska, ministre e Drejtësisë

²³Prof. Dr. Renata Deskoska, ministre e Drejtësisë

²⁴Ibid.

²⁵Natali Petrovska, drejtore ekzekutive e “Koalicioni të gjithë për gjykim të drejtë”

Partnership Justitia: Regaining Citizens' Trust

Партнерство Јуститија: Враќање на довербата на граѓаните

Partneriteti Justitia: Rikthimi i besimit të qytetarëve



praktikë e mirë është edhe pavarësia financiare në korrelacion me kapacitetet ndërsa rrjedha e mëtutjeshme e reformave duhet të siguroj mekanizma për sigurimin e pavarësisë së këtillë financiare si tek gjyqësori ashtu edhe tek Prokuroria Publike.²⁶

Akoma nuk është miratuar propozim Ligji i ri për Këshillin e Prokurorëve Publikë. Me propozim ndryshimet, ndryshime bëhen në pjesën e kompetencave të caktuara të reja të Këshillit, përkatësisht Këshilli autorizohet të vendos sipas kërkesës së paraqitur për përgjegjësi disiplinore të anëtarit të Këshillit. Ky ndryshim është në drejtim të rritjes së përgjegjësisë në punë të anëtarëve të Këshillit gjatë kohës së ushtrimit të funksionit të tyre, që të jenë më aktivë dhe në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ta ushtrojnë funksionin. Pastaj, si kompetencë e re parashikohet që Këshilli të marr vendim që anëtari i Këshillit të Prokurorëve Publikë, të mund të kryej këqyrje të drejtpërdrejt në punën e prokurorëve publikë.²⁷ Me propozim-ligjin parashikohet transparencë më e madhe në punën e Këshillit. Nga ana tjetër inkorporohet kapitull i ri me të cilin negociohet procedura për shkarkimin e anëtarit të Këshillit. Inkorporohet edhe kapitull me të cilin rregullohet procedura e përjashtimit të anëtarit të Këshillit nga puna e Këshillit të Prokurorëve Publikë. Ka ndryshime edhe në mënyrën e zgjedhjes dhe votimit gjatë zgjedhjes së anëtarit të Këshillit.²⁸

Përveç ndryshimeve të rëndësishme të ligjeve dhe miratimit të ligjeve të ri, të cilët janë me rëndësi të jashtëzakonshme për ardhmërinë Evropiane të shtetit tonë, me rëndësi të jashtëzakonshme është implementimi i tyre përkatës. Pas rumbullakimit të reformës në pjesën e miratimit të ligjeve të ri dhe ndryshimeve të ligjeve, për rikthimin e besimit të qytetarëve te gjyqësori dhe Prokuroria Publike do të duhet të pasojnë impenjime më serioze nga ana e të gjithë faktorëve përfshirë këtu Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin e Prokurorëve Publikë, por edhe të vet gjyqtarëve dhe prokurorëve në drejtim të implementimit konsekuent të ligjeve dhe përmirësimit të cilësisë së drejtësisë.²⁹ Në këtë drejtim është i rëndësishëm edhe integriteti i gjyqtarëve dhe i prokurorëve publikë. Çdo gjyqtarë duhet të qëndroj pas çdo vendimi të tij dhe të garantoj për të njëjtin në mënyrë që jo vetëm të aplikohet e drejta por edhe të avancohet drejtësia dhe ajo të jetë e dukshme.³⁰

Nevojitet debat i mirëfilltë në lidhje me vetingun ose revalorizimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë me qëllim që ky proces të mos krijoj pasoja serioze gjatë reformave dhe efikasitetit të gjyqësorit i cili është arritur. Duhet të definohet drejtimi konkret dhe propozimi për atë reformë, në cilin drejtim, në ç'mënyrë dhe me cilën metodologji do të zbatohet procesi i vetingut ose revalorizimit, cilat do të ishin pasojat në lidhje me efikasitetin e deritanishëm të

²⁶Lençe Ristovska, prokurore publike

²⁷Z. Kolevski theksoi se në të vërtetë nuk bëhet fjalë për kompetencë të re të Këshillit të Prokurorëve të Publik dhe se praktikë të këtillë Këshilli ka pasur më së shpeshti në rastet kur është parashtruar parashtresë ose ankesë nga ana e qytetarëve ose anëtarit të Këshillit me qëllim që të kontrollohen pretendimet.

²⁸Aco Kolevski, Kryetar i Këshillit të Prokurorëve Publikë

²⁹Prof. Dr. Renata Deskoska, ministre e Drejtësisë

³⁰Antoaneta Dimovska, gjyqtare



gjyqësorit dhe a mund të reformohet gjyqësori vet. Në Ligjin e ri për gjykata³¹ si bazë për shkelje më të rëndë disiplinore është përcaktuar refuzimi i gjyqtarit të jap deklarata për gjendjen pronësore dhe interesat konform ligjit ose nëse të dhënat që i përmban deklarata në masë të madhe janë të pavërteta. Në këtë mënyrë lihet hapësirë Këshilli Gjyqësor në koordinim me Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit të mund t'i shkarkoj nga funksioni gjyqtarët e korrumpuar.³²

Këshilli Gjyqësor përkatësisht Këshilli Buxhetor Gjyqësor i Këshillit Gjyqësor, përkatësisht Këshilli Buxhetor Gjyqësor mendoj se ka bërë mjaft edhe në lidhje me përmirësimin e statusit material të gjyqtarëve. Në rrjedhë e sipër janë negociatat me pushtetit ekzekutiv në lidhje me rritjen edhe të koeficientit të arkëtimeve.³³

Rekomandime:

- Sa më shpejtë të zgjidhen dy anëtarë të Këshillit Gjyqësor nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- Gjatë hartimit të Rregullores për notimin e gjyqtarëve nga ana e Këshillit Gjyqësor, të gjithë gjyqtarët dhe gjykatat e shtetit ta japin kontributin e tyre.
- Rritja e numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë dhe përmirësimi i kushteve hapësinore të Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë.
- Përmirësimi i kushteve hapësinore dhe ekipimi kadrovik të Gjykatës Administrative dhe të Gjykatës së Lartë Administrative.
- Vazhdimi i praktikave të inkluzivitetit dhe rritja e inkluzivitetit për formimin e grupeve të punës për hartimin e ligjeve si dhe debate dhe propozime gjithëpërfshirëse në lidhje me zgjidhje të caktuara të cilat janë me rëndësi të jashtëzakonshme për qytetarët (Ligji për procedurë penale, Ligji për marrëdhënie detyimore, Ligji për procedurë kontestimore).
- Duhet të miratohet Ligji i ri për Prokurorinë Publike në të cilin rregullohet kalimi i të gjitha procedurave nga PSP në Prokurorinë e Rregullt Publike, si dhe të miratohen ndryshimet e Ligjit për Këshillin e Prokurorëve Publikë.
- Duhet të ruhen praktikat e mira të cilat i vendosi Prokuroria Speciale Publike gjatë punës së saj nga aspekti i resurseve njerëzore edhe në Prokurorinë Publike për Ndjekjen e Krimit dhe Korrupsionit të Organizuar.
- Pavarësi më e madhe financiare e gjyqësorit dhe Prokurorisë Publike.
- Krahas të gjitha ndryshimeve të rëndësishme të ligjeve dhe miratimit të ligjeve të ri, të cilët kanë një rëndësi të jashtëzakonshme për ardhmërinë Evropiane të shtetit tonë, me rëndësi të jashtëzakonshme është implementimi i tyre përkatës nga ana e të gjithë faktorëve kryesorë.

³¹Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykata.

³²Prof. Dr. Renata Deskoska, ministre e Drejtësisë

³³Kiro Zdravev, kryetar i Këshillit Gjyqësor



- Nevojitet debat i mirëfilltë në lidhje me vettingun ose revalorizimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë, me qëllim që ky proces të mos shkaktoj pasoja serioze sa i përket rrjedhës së reformave dhe efikasitetit të gjyqësorit i cili është arritur.

Sesioni 2: Legjislacioni i të drejtës – penale, i të drejtës – civile dhe ndërmjetësimi

Sesioni i dytë i dialogut iu dedikua reformave të legjislacionit juridiko – penal, juridiko – civil dhe ndërmjetësimit, reforma këto me rëndësi jashtëzakonisht të madhe për qytetarët. Në këtë sesion diskutuan L Lazar Nanev, profesor inordiner dhe gjyqtar në Gjykatën Themelore në Kavadar; Olja Ristova, gjyqtare në Gjykatën Themelore Penale; Antoneta Dimovska, gjyqtare në Gjykatën Themelore Civile; Radica Llazaraska Gerovska, këshilltare shtetërore në Ministrinë e Drejtësisë. Në fund Aleksandar Nikollov drejtor ekzekutiv i Asociacionit ZENIT i prezantoi rezultatet pleniminare nga anketa për shfrytëzuesit gjyqësorë dhe aktivitetet të cilat zbatohen në kuadër të këtij projekti. Sesionin e moderoi Iva Conevska, menaxhere e projektit dhe hulumtuese në Institutin për Politikë Evropiane.

Sistemi i drejtësisë për fëmijë është vendosur me Ligjin për të drejtën e të miturve, i avancuar me Ligjin për drejtësi për fëmijë akoma ballafaqohet me ekzistimin e kushteve të këqija materiale, mungesën e arsimit fillor dhe me risocializimin sistematik të fëmijëve të privuar nga liria, kështu që sugjeron që të ketë kujdes serioz dhe nevojë për përpjekje për fuqizimin plotësues të të drejtave të fëmijëve. Në Strategji u konstatua se akoma ekziston mosharmonizimi i Ligjit për drejtësi për fëmijë me Ligjin e ri për procedurë penale dhe me Ligjin për kundërvajtje, si dhe me direktivat e BE-së. Prandaj, theksohet se nevojiten ndryshime të Ligjit për drejtësi për fëmijë, në drejtim të harmonizimit të tij me ligjet e tjerë dhe me direktivat e BE-së, përforcimi i mbrojtjes së fëmijëve viktimë të veprave penale, inkorporimi i dispozitave procedurale në lidhje me rrjedhën e seancës kryesore, lehtësimi i qasjes së fëmijëve – viktimë deri te këshilla juridike, si dhe avokimi dhe formimi i Fondit për dëmshpërblimin e fëmijëve viktimë.³⁴

Ndryshimet doemos duhet t'i përforcojnë edhe mekanizmat për parandalimin e delikuençës së fëmijëve në nivel lokal dhe qendror, si dhe përforcim institucional, material dhe funksional të Këshillit Shtetëror për Parandalimin e Delikuençës së Fëmijëve.³⁵

Në këtë drejtim në Ministrinë e Drejtësisë u formua grupi i punës për hartimin e propozim – Draft Ligjit për drejtësinë e fëmijëve.³⁶ Përveç faktit që u formua grupi i punës për hartimin e Ligjit të ri për drejtësinë e fëmijëve, me mbështetjen e zyrës së UNICEF, ekspertë nacional përpiluan listë me 32 indikatorë për monitorimin e implementimit të Ligjit për drejtësi për fëmijë, ndërsa për nevojat e Këshillit Shtetëror për Delikuençën e Fëmijëve i cili i mbledhë nga 63 institucione në sistemin e drejtësisë për fëmijë edhe atë: tetë SPB, 30 QPS, 12 gjyqtarë themelorë

³⁴Lazar Nanev, profesor inordinar dhe gjyqtar në Gjykatën Themelore në Kavadar.

³⁵ibid.

³⁶I padituri, nga ana tjetër, do të paraqes akt-ekspertizë me përgjigjen ndaj padisë ose gjykata konform nenit 235 paragrafi 2 do të përcaktoj ekspertizë me urdhër të shkruar, nëse është e besueshme se ka ekzistojnë fakte ose rrethana për shkak të të cilave nuk mund ta siguroj gjetjen dhe opinionin e ekspertit mjeko ligjor.

Partnership Justitia: Regaining Citizens' Trust

Партнерство Јуститија: Враќање на довербата на граѓаните
Partneriteti Justitia: Rikthimi i besimit të qytetarëve



me kompetencë të zgjeruar, 12 PTHP dhe 1 PTHP për ndjekjen e veprave penale të krimit dhe korrupsionit të organizuar. Të dhënat e fituara statistikore përmes indikatorëve, përpunohen statistikisht dhe janë pjesë të Raportit vjetor të Këshillit Shtetëror për Delikuecën e Fëmijëve të cilin e miraton Kuvendi i RMV.³⁷

Zbatimi i Ligjit për procedurë penale akoma është një sfidë.³⁸ Problem më i madh në lidhje me procedurën penale është mos paraqitja e provave nga ana e Prokurorisë Publike deri te mbrojtja në fillim të procedurës. Në Ligjin për procedurë penale është parashikuar obligimi për kryerjen e këqyrjes gjatë hetimit nga ana e prokurorit publik. Kjo dispozitë interpretohet në atë mënyrë që kufizohen të drejtat e mbrojtjes gjatë procedurës penale. Interpretimi i këtillë shkakton probleme gjatë procedurës dhe shpeshherë për shkak të nevojës për përgatitje përkatëse të mbrojtjes shtyhet edhe seanca kryesore. Duhet të përmirësohen edhe resurset materiale³⁹ në prokuroritë publike në mënyrë që më lehtë dhe në mënyrë më efektive t'i paraqiten provat mbrojtjes.

Një sfidë në vete është edhe Instituti Ujdi për Fajin.⁴⁰ Ky Institut fillimisht u krijua në atë mënyrë që në pjesën më të madhe të procedurave, madje deri në 90 për qind të procedurave, ku ekzistojnë prova të fuqishme dhe të pakontestueshme nga ana e Prokurorisë Publike të shfrytëzohet ky Institut. Sipas statistikave të Gjykatës Themelore Penale për vitin 2017 dhe 2018 vetëm 10% e procedurave kanë përfunduar me ujdi për fajin, ndërsa procedurat e tjera janë dërguar si akuza deri te gjykatat. Njëri nga shkaqet që i japin prokurorët publikë për mos aplikimin e këtij instituti për veprat për të cilat është përcaktuar dënim me burgim deri në 5 vjet është se ata nuk kanë obligim ligjor ta gjejnë të akuzuarin. Ka situata në të cilat i akuzuari për herë të parë kupton për procedurën kur do ta pranoj thirrjen nga gjykata. Kjo duhet të korrigjohet në atë mënyrë që në dispozitat në të cilat rregullohet procedura e shkurtuar në Ligjin për procedurë penale, si dhe për veprat penale më të rënda, të potencohet se i akuzuari duhet detyrimisht të njoftohet nga Prokuroria Publike se kundër tij është ngritur procedurë penale që të mundet në mënyrë përkatëse ta përgatisë mbrojtjen e tij.⁴¹ Gjithashtu, nevojiten edhe ndryshime ligjore në drejtim të regjistrimit të seancave gjyqësore pa obligim për dhënien e procesverbalit. Procesverbali të jepet në kushte të caktuara edhe atë kur një gjë të këtillë e kërkon pala. Në këtë mënyrë do të përshpejtohet zhvillimi i seancës kryesore.⁴²

Duhet të përmirësohet menaxhimi me procedurat gjyqësore nëpër gjykata. Shpeshherë kemi zvarritje të procedurave. Nevojitet një aktivitet më i madh i Këshillit Gjyqësor në këtë drejtim.⁴³ Nevojitet lidhje më e mirë elektronike ndërmjet institucioneve⁴⁴ dhe dërgesat të bëhen me postë elektronike.⁴⁵ Është i domosdoshëm edhe fuqizimi i menaxhmentit të gjykatave,

³⁷Ibid.

³⁸Olja Ristova, gjyqtare në Gjykatën Themelore Penale.

³⁹Për shembull furnizimi i fotokopirit dhe skanerit.

⁴⁰Olja Ristova, gjyqtare në Gjykatën Themelore Penale.

⁴¹Olja Ristova, gjyqtare në Gjykatën Themelore Penale.

⁴²Ibid.

⁴³Olja Ristova, gjyqtare në Gjykatën Themelore Penale.

⁴⁴Gjykata, prokurori publike, MPB.

⁴⁵Olja Ristova, gjyqtare në Gjykatën Themelore Penale.



veçanërisht të kryetarëve të gjykatave, të cilët duhet të angazhohen më shumë për veprimet e kryetarëve të departamenteve dhe nëse të njëjtit veprojnë sipas kërkesave dhe nevojave të gjyqtarëve. Ka nevojë nevojë edhe për punësimin e më shumë bashkëpunëtorëve dhe nëpunësve profesional me qëllim të rritjes së kualitetit të punës së gjyqtarëve, si dhe azhurnim i rregullt i sistemit AKMIS.⁴⁶

Ligji për llojin dhe lartësinë e sanksioneve penale u anulua si i pazbatueshëm. Megjithatë, ballafaqohemi me mos unifikim të dënimeve nga ana e gjyqtarëve në procedurën penale. Në këtë drejtim, rekomandohet të miratohet Udhëzues me kritere dhe parametra për unifikimin e praktikës gjyqësore për përcaktimin e llojit dhe lartësisë së sanksionit penal.⁴⁷

Në vitin 2011 u miratua Ligji për shërbimin e provës, megjithatë shërbimi i provës nuk shfrytëzohet mjaftueshëm nga ana e gjyqtarëve. Ky Ligj ka një rëndësi jashtëzakonisht të madhe për përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prandaj, rekomandohet trajnim intensiv të gjyqtarëve për aplikimin e Ligjit për shërbimin e provës me qëllim bashkëpunimi me shërbimin e provës mundëson një qasje të drejtë deri te individualizimi i dënimit për çdo të akuzuar.⁴⁸ ndryshime nevojiten edhe në dispozitat për mbikëqyrje të mbrojtur në Kodin Penal në drejtim të zmadhimit të llojit të masave të cilat do t'i shqiptoj gjykata me qëllim të reduktimit të numrit të recidivistëve. Masat të cilat i parashikon Kodi Penal janë të pamjaftueshme, meqë ka shumë situata të ndryshme dhe prandaj spektri i masave duhet të rritet.⁴⁹

Në fushën e të drejtës civile duhet të bëhen ndryshime në Ligjin për procedurë kontestimore në pjesën e ekspertizës. Me ndryshimet e Ligjit për procedurë kontestimore nga viti 2010, kur u ndryshua Kapitulli XXVII në pjesën e provave, këqyrje dhe ekspertizë duhej të arrihej përsheptimi i procedurave gjyqësore. Megjithatë, një numër i madh i lëndëve përfundojnë me superekspertizë, por para kësaj ka edhe faza të tjera të procedurës të cilat nuk zhvillohen edhe aq “shpejt”.⁵⁰

Probleme paraqiten edhe me kontestet me vlerë të vogël sipas zgjidhjes aktuale ligjore. Në përputhje me zgjidhjen aktuale ligjore kontest me vlerë të vogël si në seancën e rregullt ashtu edhe në kontestet ekonomike janë konteste që kanë të bëjnë me kërkesën monetare e cila nuk e tejkalon shumën prej 600.000,00 denarë. Është e pajustificueshme që kjo shumë të jetë e njëjtë edhe për kontestet ekonomike edhe për seancat e rregullta duke e pasur parasysh fuqinë financiare të qytetarëve kjo shumë assesi nuk mund të jetë kontest me vlerë të vogël.⁵¹ Shkaku i dytë konsiston me atë se me këto ndryshime u lejua ankesë për gjendjen faktike, me ç'rast ky kontest u barazua plotësisht me seancën e rregullt gjyqësore, ndërsa mbeti dispozita se nuk mbahet seancë përgatitore

⁴⁶Ibid.

⁴⁷⁴⁷Ibid.

⁴⁸Ibid.

⁴⁹Ibid.

⁵⁰Antoaneta Dimovska, gjyqtare në Gjykatën Themelore Civile.

⁵¹Ibid.



gjqësore por menjëherë caktohet seancë gjyqësore për seancën kryesore, e që rezultoi në një procedurë krejtësisht konfuze.⁵²

Në pjesën e të drejtës materiale civile, para fillimit të kodifikimit të së drejtës civile, i cili është një proces afatgjatë, aktualisht problem më i madh është mosharmonizimi i ligjeve materiale të cilët nga aspekte të ndryshme trajnojnë një çështje të njëjtë. Nevojitet analizë e detajuar e ligjeve sipas grupeve, për shkak të konstatimit të mos konsekuencave të theksuara.⁵³

Përpyekja e tretë për jetësimin e plotë të konceptit të ndërmjetësimit⁵⁴ u ndërmor me hartimin e propozim – Ligjit të ri për ndërmjetësim i cili aktualisht është i bllokuar në procedurë parlamentare. Me këtë propozim ligj, por edhe me Ligjin për ndërmjetësim nga viti 2013 u implementua Direktiva nga viti 2008. Megjithatë, në propozim Ligjin i cili u hartua në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë në mënyrë plotësuese janë ndjekur udhëzimet e Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (SEREJ) për zhvillimin e ndërmjetësimit, si dhe rekomandime nga Parlamenti Evropian. Në mënyrë plotësuese u bënë përpjekje për mbikëqyrjen e ndryshimeve të nevojshme në ligje të tjerë⁵⁵ për avancimin e konceptit të ndërmjetësimit. Nevojitet të revidohen dispozitat e propozim Ligjit për ndërmjetësim të cilat kanë të bëjnë me Këshillin për Ndërmjetësim. Fillimisht, Këshilli për Ndërmjetësim në praktikë u dëshmuar si një organ tejet i madh, i cili është mjaft i komplikuar për kryerjen e funksioneve të tij.⁵⁶

Përveç nevojës për ndryshimin e Ligjeve, për avancimin e konceptit të ndërmjetësimit nevojiten edhe masa shpesh. Nevojiten edhe mjete buxhetore për shfrytëzimin më të madh të ndërmjetësimit konform Ligjit për drejtësinë e fëmijëve, veçanërisht duke e pasur parasysh faktin se ndërmjetësimi nënkupton më pak shpenzime për palët por, nga ana tjetër, vendos një situatë në të cilën nuk ekziston ndjenja e palës humbëse. Në këtë drejtim, Prokuroria në momentin kur e krijon buxhetin e vet duhet të ketë një vlerësim për numrat e lëndëve që kanë të bëjnë pikërisht me fëmijët.

Në korrik të vitit 2019, në bashkëpunim me Dhomën e Ndërmjetësuesve, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi Konkluzion me të cilin i ngarkoi të gjitha organet shtetërore, institucionet, ndërmarrjet publike në pronë shtetërore, por edhe njësitë e vetëqeverisjes lokale, para se të fillojnë procedurë gjyqësore, të bëjnë përpjekje që kontestet t'i zgjidhin përmes ndërmjetësimit.⁵⁸

Për vitin 2017, 2018 dhe 2019 ka rreth 1464 lëndë për ndërmjetësim. Nga këto lëndë ka 1111 ujdi, përkatësisht 75% e lëndëve kanë përfunduar me ujdi. Duhet të bëhen përpjekje që të

⁵²Ibid.

⁵³Ibid.

⁵⁴Radica Lazareska Gerovska, këshilltare shtetërore në Ministrinë e Drejtësisë

⁵⁵Ligji për marrëdhënie detyimore, Ligji për procedurë kontestimore, Ligji për drejtësinë e fëmijëve.

⁵⁶Radica Lazareska Gerovska, këshilltare shtetërore në Ministrinë e Drejtësisë

⁵⁷Ibid.

⁵⁸Ibid.



kemi tentativa të detyrueshme për ndërmjetësim në kontestet e punës,⁵⁹ në kontestet për drejtësinë e fëmijëve, në kontestet e sigurimeve dhe në kontestet konsumatore.⁶⁰

Gjatë hartimit të ligjeve nevojitet pjesëmarrje të gjyqtarëve, prokurorëve publikë dhe të personave të tjerë nga praktika të cilët ballafaqohen me inkoherencën e zgjidhjeve ligjore në praktikë si dhe ekspertë. Konsultat për propozim-ligjet për zgjidhje ligjore të caktuara nuk duhet të bëhen vetëm pas përpilimit të draft zgjidhjeve ligjore.⁶¹

Rekomandime

Ligji për drejtësinë e fëmijëve

1. Respektim konsekuent të parimit të interesit më të mirë të fëmijës.
2. Harmonizimi me direktivat e sapo miratuara të BE-së që kanë të bëjnë me garancitë procedurale për mbrojtjen e fëmijëve të cilët janë të pandehur ose të akuzuar në procedurë penale.
3. Përforsimi i mbrojtjes së fëmijëve – viktimat të veprave penale, duke i përfshirë edhe masat për rehabilitimin dhe edukimin intensiv të fëmijëve.
4. Inkorporimi i dispozitave procedurale në lidhje me rrjedhën e seancës kryesore – dilema është seancë kryesore ose seancë?
5. Të lehtësohet qasja e fëmijëve – viktimat deri te këshillat juridike dhe avokimi.
6. Krijimi i Fondit për dëmshpërblimin e fëmijëve viktimat.
7. Përforsimi i mekanizmave për parandalimin e delikuencës së fëmijëve në nivel lokal dhe qendror, si dhe fuqizimi institucional, material dhe funksional të Këshillit Shtetëror për Parandalimin e Delikuencës së Fëmijëve.
8. Rishikimi i parimeve themelore.
9. Avancimi i të drejtës restorative – ndërmjetësimit dhe forma të tjera të anashkalimit të procedurës gjyqësore.
10. Rishikimi normativ i veprimit dhe roli i qendrave për mbrojtje sociale.
11. Ndryshime në pjesën materiale në lidhje me institucionet në të cilat ekzekutohen sanksionet ndaj fëmijëve.
12. Rregullimi normativ i Ndhmës juridike falas – përkatësisht të kompensimi i avokatëve para QPS dhe policisë.
13. Inkorporimi i dispozitave procedurale në lidhje me rrjedhën e seancës verbale.
14. Rishikimi i dispozitave të cilat përmbajnë elemente restorative me qëllim të tejkalimit të problemeve të detektuara të cilët e pamundësojnë aplikimin e tyre më të shpeshtë.
15. Rishikimi i procedurave të cilat i ndërmerr QPS dhe përforsimi i autorizimeve të saj në lidhje me ekzekutimin e sanksioneve.

⁵⁹Mbi 1300 lëndë nga lëndët të cilat zgjidhen përmes ndërmjetësimit janë nga fusha e marrëdhënieve të punës.

⁶⁰Radica Lazareska Gerovska, këshilltare shtetërore në Ministrinë e Drejtësisë

⁶¹Vladimir Tufegxhiq, gjyqtar në Gjykatën Themelore Penale.

Partnership Justitia: Regaining Citizens' Trust

Партнерство Јуститија: Враќање на довербата на граѓаните
Partneriteti Justitia: Rikthimi i besimit të qytetarëve



16. Avancimi i të Drejtave të fëmijëve - viktima.
17. Rishikimi i dispozitave në lidhje me kompetencën për ekzekutimin e sanksioneve.
18. Inkorporimi i dispozitave në lidhje me organikën institucionale të EEK.
19. Lehtësimi i procedurës për dëmshpërblim.
20. Përforcimi funksional i Këshillit Shtetëror dhe Mekanizmave për Parandalimin e Delikuencës së Fëmijëve.
21. Nevojitet Transponimi i direktivave relevante të BE-së.

Ligji për procedurë penale

1. Rekomandohet të inkorporohet praktika sipas së cilës prokurori publik do ta ketë për detyrë të gjitha provat t'ia paraqes mbrojtjes në fillim të procedurës. Edhe pse ky obligim nuk rezulton nga Ligji për procedurë penale, i njëjti rezulton nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe nënshkruara nga Republika e Maqedonisë së Veriut të cilat janë pjesë përbërëse të legjislacionit vendor.
2. Rekomandohet qasja drejt propozimit për ujdë të fajit çdoherë kur prokuroria ka në dispozicion prova të fuqishme për lëndën.
3. Ndryshimi i dispozitave të Ligjit për procedurë penale në pjesën e procedurës së shkurtuar, me qëllim të njoftimit të detyrueshëm të të akuzuarit kur ka filluar hetimi ose kur grumbullohen provat.
4. Ndryshime ligjore në drejtim të regjistrimit të seancave gjyqësore pa obligim për dhënien e procesverbalit.
5. Fuqizimi i kapaciteteve të gjykatave përmes punësimit të një numri më të madh të bashkëpunëtorëve dhe nëpunësve profesionistë, me qëllim të ngritjes së kualitetit të punës së gjyqtarëve.
6. Kontrolli dhe detektimi i problemeve kryesore për shkak të të cilave prolongohen seancat gjyqësore dhe në këtë bazë të realizohet trajnim për gjyqtarët për menaxhimin e lëndëve me qëllim të efikasitetit gjatë veprimit.
7. Përforcimi i menaxhmentit të gjykatave në drejtim të shpërndarjes së drejtë të gjyqtarëve dhe shërbimeve gjyqësore nëpër departamente, me qëllim të rritjes së efikasitetit gjatë veprimit me lëndët.
8. Azhurnimi i rregullt i sistemit AKMIS në përputhje me nevojat e përditshme të të gjithë shfrytëzuesve të këtij sistemi.
9. Anëtarët e Këshillit Gjyqësor të kenë komunikim të vazhdueshëm me gjyqtarët e gjykatave për të cilët janë kompetentë, me qëllim që në mënyrë të drejtë t'i konstatojnë problemet e gjyqtarëve të cilat ndikojnë në vlerësimin e punës së tyre.

Kodi Penal



Projekti është financuar nga
Bashkimi Evropian

Partnership Justitia: Regaining Citizens' Trust
Партнерство Јустисија: Враќање на довербата на граѓаните
Partneriteti Justitia: Rikthimi i besimit të qytetarëve



Projekti është bashkëfinancuar
nga Qeveria e Republikës së
Maqedonisë së Veriut

1. Rekomandohet të hartohet Udhëzim për ujdj për llojin dhe lartësinë e sanksionit penal, me qëllim të praktikës së unifikuar gjyqësore të gjykatave, si dhe përmirësimi i azhurnimit të të dhënave në sistemin AKMIS për të marrë të dhëna për sanksionin e shqiptuar mesatar për ndonjë vepër të caktuar penale.
2. Rekomandohet të miratohet Udhëzim për unifikimin e praktikës gjyqësore për përcaktimin e llojit dhe lartësisë së sanksionit penal.
3. Trajnim intensiv për gjyqtarët për zbatimin e Ligjit për shërbimin e provës, meqë bashkëpunimi me shërbimin e provës mundëson qasje të drejtë në drejtim të individualizimit të dënimit për çdo të akuzuar.
4. Ndryshime të dispozitave për mbikëqyrje të mbrojtur në Kodin Penal, në drejtim të rritjes së llojit të masave të cilat do t'i shqiptoj gjykata, me qëllim të reduktimit të numrit të recidivistëve.

Legjislacioni procesual civil

1. Në fushën e të drejtës civile nevojiten ndryshime në Ligjin për procedurë kontesimore në pjesën e ekspertizës dhe tek kontestet me vlerë të vogël.
2. Revidimi i afateve në Ligjin për procedurë kontestimore me qëllim të përmirësimit të cilësisë së vendimeve gjyqësore.

Legjislacioni material civil

1. Para se të fillohet me kodifikimin e të drejtës civile, nevojitet të bëhet një analizë e detajuar e ligjeve sipas grupeve, me qëllim të tejkalimit të mos harmonizimit të ligjeve materiale të cilët nga aspekte të ndryshme trajtojnë një çështje të njëjtë.

Ndërmjetësimi

1. Miratimi i Ligjit të ri për ndërmjetësim nga ana e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
2. Rishikimi i dispozitave që kanë të bëjnë me Këshillin për Nërmjetësim.
3. Inkorporimi i përpjekjes së detyrueshme për ndërmjetësim tek kontestet e punës, kontestet për drejtësinë e fëmijëve, kontestet e sigurimeve dhe kontestet e konsumatore.
4. Zbatimi i konkluzionit të Qeverisë nga muaji korrik i vitit 2019 me të cilin obligohen të gjitha organet shtetërore, institucionet, ndërmarrjet publike të cilat janë në pronë shtetërore, por edhe njësitë e vetëqeverisjes lokale, para se të fillojnë procedurë gjyqësore, të bëjnë përpjekje kontestet t'i zgjidhin me ndërmjetësim.





Projekti është financuar nga
Bashkimi Evropian

Partnership Justitia: Regaining Citizens' Trust
Партнерство Јустисија: Враќање на довербата на граѓаните
Partneriteti Justitia: Rikthimi i besimit të qytetarëve



Projekti është bashkëfinancuar
nga Qeveria e Republikës së
Maqedonisë së Veriut

ANEKSI 1

Prof. Dr. Llazar Nanev, gjyqtar në Gjykatën Themelore Kavadar

Fakulteti Juridik - Shtip

Shkup, 11.12.2019

Dialog për politikat publike “Implementimi i Strategjisë për Reformë të Sektorit të Jurisprudencës 2017–2022”

1.KONCEPTI I LIGJIT PËR DREJTËSI PËR FËMIJË – PËRPARËSITË, DOBËSITË DHE SFIDAT KRYESORE

1. 1. Koncepti i Ligjit për drejtësi për fëmijë

Ligji për drejtësi për fëmijë nga viti 2013 (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 148/2013) e rrumbullakoi sistemin e drejtësisë për fëmijë, i bazuar në Ligjin paraprak për të drejtën e të miturve. Miratimit të tij i parapriu analiza e ligjeve të mëparshëm dhe zbatimi i tyre në praktikë e që e vuri në dukje nevojën për ndërhyrje në tekstin e ligjit, krahas dobësive të detektuara gjatë zbatimit të dispozitave të tij. Në një pjesë të madhe risitë e ligjit u imponuan me kërkesën për harmonizimin e mëtutjeshëm të tij me normat dhe standardet ndërkombëtare, në kuptimin esencial dhe terminologjik (ligji operon me shprehjen “fëmijë”, në vend të shprehjes së mëparshme “i mitur”), si dhe me ndryshimet e bëra në legjislacionin vendor që kanë të bëjnë me disa dispozitat të tij, veçanërisht me miratimin e Ligjit të ri për procedurë penale në vitin 2010.

Ligji i avancon parimet mbi të cilat u bazuan edhe zgjidhjet e mëparshme, veçanërisht duke i zhvilluar kategoritë e reja të fëmijëve në konflikt dhe fëmijëve në rrezik në përputhje me standardet ndërkombëtare. Është mjaft e rëndësishme se kemi zgjerim të kategorisë “fëmijë në rrezik”, si gjendje e cila përfshinë edhe kryerje të veprimeve të parashikuara si vepra më të lehta penale, për të cilat është parashikuar (jo, si në ligjin “i përcaktuar”) dënim në para ose dënim me burgim deri në tre vjet, konform “Rregullave të Riadit” (shih më gjerë *Int.Rev.of Crim.Policy*



Projekti është financuar nga
Bashkimi Evropian

Partnership Justitia: Regaining Citizens' Trust
Партнерство Јуститија: Враќање на довербата на граѓаните
Partneriteti Justitia: Rikthimi i besimit të qytetarëve



Projekti është bashkëfinancuar
nga Qeveria e Republikës së
Maqedonisë së Veriut

49/50,12). Kuptimi dhe qëllimi i zgjerimit të tij është definimi i masave për mbrojtje të hershme dhe intervenimi preventiv ndaj fëmijëve të cilët janë në situatë të rrezikut social, para se të bëhet akti i kryerjes ose pas veprimit të kryer të parashikuar si vepër e lehtë penale, por edhe shmangie në këtë rast të procedurës formale dhe zbatimin e masave të parashikuara me ligj. Nocioni i rrezikut përgjithësisht i përfshinë situatat në të cilat fëmijët janë të rrezikuar dhe kanë nevojë për masa jopunitive, me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të tyre, edukimit dhe ndihmës. Masat e këtilla mund të fokusohen tek fëmija dhe atëherë e fitojnë karakterin e mbrojtjes dhe ndihmës, ose tek familja e tij dhe tek ndonjë mjedis tjetër (institucione arsimore), me qëllim të aktivizimit të saj si garanci për mbrojtjen dhe edukimin e fëmijës. Rreziku mund të krijohet me faktorë që i referohen vet personalitetit (shëndeti mentor i fëmijës), marrëdhënieve të fëmijës me familjen (familje e shkatërruar, keqtrajtim, lypje etj.), ose kushteve socio-ekonomike në të cilat jeton fëmija (varfëri etj.). “Rregullat e Riadit” i referohen përcaktimit se personat e rinj duhet të kenë rol aktivë dhe marrëdhënie partneriteti me shoqërinë në socializmin e tyre dhe nuk mund të konsiderohen si një objekt i zakonshëm i socializimit ose kontrollit. Parandalimi nuk e nënkupton vetëm shmangien e faktorëve negativë, por edhe avancimin e të drejtave dhe mirëqenien e fëmijës. Intervenimi i shteti duhet të vendoset në tri rrafshë. I pari është parandalimi primar dhe përmban masa dhe politika të fokusuara drejt popullatës së përgjithshme. Rrafshi i dytë ka të bëjë me parandalimin sekondar, i cili ka për qëllim identifikimin e “fëmijëve në rrezik”, për çka janë angazhuar agjenci të specializuara, detyra e të cilave është parandalimi i kryerjes së veprimeve të parashikuara si vepra penale dhe realizohet në gjashtë faza: identifikimi i problemit (punonjës social, mësues, policia në kontakt me prindërit etj.); locimi i problemit (në mjedisin në të cilin ekziston rrezik i këtyllë); identifikimi i fëmijëve (grumbullimi i informacioneve për grupe të të miturve në rrezik); vendosja e kornizës kohore për veprim (e koordinuar nga më shumë struktura, edukatorë etj.); monitorimi i programit; dhe monitorimi i mëtutjeshëm, që të mos kemi përsëritje/recidivizëm. Parandalimi terciar përfshinë masa për raste individuale dhe ka për qëllim reduktimin e recidivizmit. Kategoria “fëmijë në rrezik” nuk njeh kufij të moshës: fëmija në cilëndo qoftë moshë mund të jetë në gjendje të rrezikut, kështu që duhet të përcaktohen obligime të qarta të shtetit për ndihmë dhe kujdes për ruajtjen e shëndetit dhe zhvillimit të drejtë të tij.

Me nocionin “fëmijë në konflikt me ligjin” nënkuptohet fëmija mbi moshën 14 vjeçare veprimi i të cilit në aspektin objektiv nënkupton shkelje të ndonjë ndalimi penal – juridik, për të cilin është parashikuar (jo “përcaktuar”) dënim me burgim mbi tre vjet të cilit në kushte të caktuara mund t’i shqiptohet masa edukative ose ndonjë masë tjetër.

Dallimi i brendshëm i këtij nocioni me nocionin paraprak “fëmijë në rrezik” e posedon aspektin kuantitativ dhe kualitativ. Aspekti i parë ka të bëjë me kufirin e moshës (14 vjet), mbi të cilën fëmijët janë “në konflikt me ligjin”. Aspekti i dytë pa të cilin ky dallim nuk do të kishte kuptim, i mbulon kushtet e zbatimit të masave edukative dhe masave të tjera të “fëmijëve në konflikt me ligjin” në procedurë formale gjyqësore.

Ligji për drejtësi për fëmijë i zhvillon dhe riprecizon kushtet e dejuridizimit dhe fleksibilitetit të trajtimit të fëmijëve, në përputhje me orientimin e tij në drejtim të të drejtave dhe mirëqenies së



fëmijës, duke iu dhënë autorizime të gjera diskrecioni autoriteteve të cilët marrin pjesë në procedurë. Hapësirë për realizimin e tyre në interes të fëmijës janë zgjidhjet e inspiruara me idenë e “zmbropsjes ” (diversion) të trajtimit të “fëmijës në konflikt me ligjin” nga procedura formale gjyqësore drejt masave joformale të ndihmës dhe kujdesit në bashkësi. Trajtimi alternativ bëhet parimi themelor i sistemit bashkëkohor të drejtësisë së të miturve në atë masë që zbatimi i masave institucionale gjyqësore ose i masave të ngjashme kufizohet vetëm në rastet në të cilat mbrojtja e shoqërisë e imponon trajtimin e tyre në procedurë formale gjyqësore. “Zmbropsja” e veprimit të të miturve në drejtim të trajtimit jashtëgjyqësor çdoherë e nënkupton veprimin e fëmijës me të cilin janë realizuar karakteristikat e ndonjë veprë penale dhe pëlqimi i tij dhe pjesëmarrja aktive në zbatimin e masave tjera të cilat i nënkuptojnë alternativat e procedurës gjyqësore ose alternativat e trajtimit institucional. Mbetet kërkesa themelore, zbatimi i trajtimit alternativ jashtëgjyqësor të korrespondoj me të drejtat e tij dhe garancitë formale, siç është e drejta e mbrojtjes dhe veprimit të ndershëm dhe të drejtë (shih. më gjerë) *Int.Rev.of Crim.Policy* 49/50, 17).

Fusha qendrore në të cilën zhvillohet koncepti i ri i drejtësisë për fëmijë është sistemi i sanksioneve. Me braktisjen e konceptit të fajit dhe dënimit si përgjigje e zbatueshme ndaj veprës së kryer penale, sistemi i sanksioneve në Ligjin për drejtësi për fëmijë në vetvete plotësisht e inkorporon idenë e drejtësisë restorative (restorative justice, B. Walter, 760). Dallimi ndërmjet drejtësisë retributive dhe restorative – e para si parim dominues për të drejtën penale për kryerësit e rritur të veprave penale, e dyta korrespondon me sistemin e drejtësisë për fëmijë, fillimisht përbëhet nga relacionet e ndryshme ndërmjet subjekteve të caktuara: e para korrespondon me marrëdhënien e dyanshme midis shtetit dhe kryerësit, në të cilin kryerësi i pastron hesapet me shtetin, ndërsa e dyta nënkupton marrëdhënie trepalëshe ndërmjet kryerësit, viktimës dhe shtetit në të cilën shteti është vetëm ndërmjetësues në procesin e barazimit ndërmjet kryerësit dhe viktimës. Pastaj, drejtësia retributive e nënkupton barazimin abstrakt me veprën e kryer përmes shqiptimit të dënimit si barazim i realizueshëm: drejtësia është e kënaqur në një mënyrë të përgjithshme metafizike, vepra penale është shlyer, por me këtë nuk është restauruar gjendja e mëparshme. Drejtësia restorative kundrejt kësaj, e nënkupton vendosjen e sërishme të statusit të mëhershëm dhe të drejtave të viktimës, përmes një aktiviteti të caktuar konkret të kryerësit në drejtim të viktimës. Nga njëra anë, drejtësia retributive korrespondon me çështjen si të dënohet kryerësi, nga ana tjetër drejtësia restorative korrespondon me çështjen si të restaurohet mirëqenia e fëmijës, viktimës dhe bashkësisë.

Përkundrejt drejtësisë retributive, e cila fokusohet kah e kaluara (barazim me veprën e kryer), drejtësia restorative orientohet drejt ardhmërisë: parandalim special dhe risocializim të kryerësit, satisfaksion i të dëmtuarit në formë të kompensimit të dëmit dhe kënaqje të nevojave të bashkësisë për parandalimin e veprave penale.

Sanksioni retributiv nuk e zgjidh konfliktin bazik midis kryerësit dhe të dëmtuarit dhe mund të jetë burim edhe i konflikteve të reja, veçanërisht nëse vazhdon armiqësia e ndërsjellë midis tyre. Përkundrejt kësaj, drejtësia restorative orientohet në drejtim të zgjidhjes së konfliktit, përmes



pajtimin dhe kompensimin të dëmit ose përmes zbatimit të ndonjë sanksioni tjetër që është i pranueshëm për të gjithë (punë me dobi të përgjithshme dhe ngjashëm).

Shprehje më eksplicite e parimit të drejtësisë restorative në Ligjin për drejtësi për fëmijë është instituti i ndërmjetësimit dhe pajtimin (ndërmjetësimi): gjyqtari ose prokurori publik nuk marrin vendim dhe nuk shqiptojnë sanksion, por ndërmjetësojnë në kontestin midis fëmijës dhe familjes së tij dhe të dëmtuarit, duke e kërkuar solucionin më të mirë që do t'i kënaq interesat e të gjitha palëve.

Pranimi i idesë së drejtësisë restorative si parim prijës i drejtësisë për fëmijë ballafaqohet me paralajmërimet e arsyeshme për respektimin e garancive themelore shtetërore - juridike (v. *Jessberger/Kress*, 846): sistemi i drejtësisë për fëmijë duhet të harmonizohet me parimet e shtetit juridik, me liritë dhe të drejtat e fëmijëve dhe me nevojën për mbrojtje efikase të shoqërisë nga krimi. Së këtejmi, Ligji për drejtësi për fëmijë në mënyrë minucioze i rregullon procedurat gjyqësore dhe jashtëgjyqësore ndaj fëmijëve, duke iu referuar respektimit të të drejtave të tyre të veçanta dhe mbrojtjes së tyre dhe që ka përparësi ndaj parimit të efikasitetit të veprimit. Nga ana tjetër, potencimi i interesit të fëmijës dhe nevoja për socializmin e tij si qëllim primar i sistemit të sanksioneve e shlyen dallimin ndërmjet zgjidhjeve materiale – juridike dhe procesuale – juridike. Procedura e filluar për një vepër të kryer të parashikuar si vepër penale mund të përfundojë edhe me zgjidhje procesuale, siç është pajtimi, prolongimi me kusht i procedurës dhe ngjashëm. Së këtejmi, disa sanksione të caktuara, siç janë masat e mbikëqyrjes së përforcuar, janë parashikuar si “veprim” i vazhdueshëm me të miturit, ku përfshihet edhe organi i cili e kryen mbikëqyrjen, kështu që elementi personal i sanksionit përcaktohet si obligim për përmbushjen e urdhrave të caktuar, kontakteve me atë organ dhe ngjashëm.

Sanksione kryesore në sistemin e sanksioneve janë masat edukative të cilat i shqiptohen fëmijës në konflikt me ligjin, me përjashtim të fëmijës të moshës prej 16 deri 18 vjeçare për veprimin i cili është parashikuar me ligj si vepër penale t'i shqiptohet dënim ose masë alternative; fëmijës për veprimin i cili është parashikuar me ligj si kundërvajtje mund t'i shqiptohen sanksione për kundërvajtje të përcaktuara me këtë ligj; masa sigurie i shqiptohen fëmijës sipas kushteve të përcaktuara në KP dhe me këtë ligj; konfiskim të pronës dhe dobisë pronësore dhe të sendeve të fituara me veprime të cilat me ligj janë parashikuar si vepra penale dhe kundërvajtje ndaj fëmijëve bëhet në përputhje me kushtet e përgjithshme të përcaktuara në KP (neni 34). Sanksionet e parashikuara në këtë ligj kanë përmbajtje të ndryshme, e që e parapërcakton mënyrën e ekzekutimit të tyre, por kanë qëllim të vetëm që i bënë të ndryshëm nga sanksionet e ngjashme në të drejtën penale. Ajo është përkufizuar si sigurim të edukimit të tyre, riedukimit dhe zhvillimit të drejtë (neni 35), dhe së këtejmi, dënimi për fëmijë sipas kuptimit dhe qëllimit të vet ndryshon nga dënimi i kryerësve të rritur të veprave penale: qëllimi kryesor i saj është parandalimi special dhe riedukimi, kështu që ekzekutimi i tij është suspenduar nga të gjitha elementet retributiv që janë atribut të dënimit.



Qëllimi i përbashkët i të gjitha sanksioneve të parashikuara i jep një përmbajtje tjetër edhe parimit të individualizimit (neni 36) si parim kryesor në zgjedhjen dhe matjen e sanksioneve: ato implikojnë autorizime të gjera të gjyqtarit në zgjedhjen e tyre, i determinuar, krahas respektimit të rrethanave që kanë të bëjnë me personin, pesha e veprimit dhe pasojat, kryesisht nga nevoja e edukimit, riedukimit, arsimit dhe zhvillimit, me qëllim të sigurimit dhe mbrojtjes së interesit më të mirë të fëmijës; së këtejmi, dënim ose sanksion më i rëndë shqiptohet vetëm nëse nuk është i arsyeshëm shqiptimi i sanksionit më të lehtë dhe me obligim të gjyqtarit në mënyrë të veçantë t'i justifikojë shkaqet e shqiptimit të sanksionit më të rëndë.

Theksimi i primeve të individualizimit, parandalimit special dhe depenalizimit si prioritar, i bën të pakuptimtë dhe të pazbatueshëm në sistemin e drejtësisë për fëmijë rregullat e veçanta të parashikuara në të drejtën penale me ligjin e famshëm për zgjedhjen dhe matjen e lartësisë së dënimit.

Krahas “shkrirjes” të dënimeve në sistemin unik të sanksioneve parandaluese si fushë e avancimit të mëtutjeshëm të sistemit të drejtësisë për fëmijë mbetet çështja e konsistencës së tyre ose jokonsistencës me konceptin themelor mbi të cilin bazohet modeli i drejtësisë për fëmijës. Sipas Ligjit për drejtësi për fëmijës (neni 50), mund të dënohet (dënime të parashikuara janë: burg për fëmijë, dënim me para, ndalim për të drejtuar mjet motorik dhe dëbimi i të huajit nga vendi) fëmija “me përgjegjësi penale” mbi moshën 16 vjeçare vetëm nëse për shkak të pasojave të rënda nga vepra e kryer dhe shkalla e lartë e përgjegjësisë penale nuk do të ishte e arsyeshme të shqiptohet masa edukative (sipas nenit 51, kusht për shqiptimin e dënimit me burgim për fëmijë është edhe “shkalla e lartë e përgjegjësisë penale”). Këto zgjidhje të cilat janë pjesë nga vëzhgimi i fëmijëve delikuent si “kriminelë të mëhallës”, janë ndërhyrje evidente të dy ideve: të funksionit riedukativ të sanksioneve për fëmijë, nga njëra anë, dhe nga ana tjetër ndëshkimit që për bazë e ka fajin e kryerësit. Ky konfuzion gjithsesi se do të pasqyrohet në natyrën e dyfishtë të dënimit (*Schaffstein*, 461): funksion i dënimit është edhe riedukimi i të miturit, si edhe masat e tjera edukative, dhe zmbarsja e realizueshme nga vepra e kryer. Shumica e autorëve, veçanërisht pjesëtarët e drejtimit teorik të cilët e preferojnë trajtimin kundrejt dënimit, konsiderojnë se ky dualizëm i ideve inkohorente e arsyeton braktisjen e dënimit që e dëmton personalitetin e fëmijës dhe zhvillimin e tij dhe paraqitet si shkak kryesor i recidivizmit (*Heuyer*, 274).

Zgjidhjet të cilat e vënë në dukje “përgjegjësinë penale” të fëmijës mbi moshën 16 vjeçare lënë çështje të hapura, si për shembull a thua çdoherë kur bëhet fjalë për fëmijë në konflikt me ligjin gjykata duhet ta konstatoj ekzistimin e fajit apo i njëjti konstatohet vetëm atëherë kur ai do të kryej ndonjë vepër më të rëndë. Dhe madje, kjo a nënkupton se tek veprat më të lehta gjykata nuk duhet të konstatoj përgjegjësi penale, e që mundëson vepra të mos jetë e kryer me dashje, përkatësisht nga pakujdesia, në rastet kur ligji e dënon pakujdesinë. Çështja e fundit e implikon këtë si vijon: nëse gjykata konstaton se nuk ekziston dashje ose pakujdesi, atëherë shtrohet pyetja a mundet të zbatohet ndonjë sanksion. Kur do të pranohej teza se faji përcaktohet vetëm tek veprat më të rënda, mbetet mundësia e zbatimit të masave edukative pa marrë parasysh se a ekziston faji tek fëmija për veprën e kryer, ndërsa kjo (në bazë të konkluzionit adabsurdum), do të thotë zbatim



të masës së entit, për shembull, edhe për ndonjë rast të rëndomtë, në të cilin është shkaktuar pasojë relevante-juridike pa ekzistuar as pakujdesia nga ana e kryerësit. Prandaj, gjykata duhet t'i konstatoj të gjitha elementët e sjelljes subjektive të fëmijës në konflikt me ligjin në moshë 16 vjeçare ndaj veprës së tij në çdo rast kur hapet procedurë.

Së këtejmi, kur do të konstatohet faji (dashje ose pakujdesi, nëse pakujdesia dënohet) për veprën e kryer më të rëndë, mund të shqiptohet edhe dënim me burgim për fëmijë nëse janë përmbushur edhe kushtet e tjera për shqiptimin e tij; në raste tjera për shqiptimin e masës edukative mjafton të konstatohet ekzistimi i sjelljes së atillë subjektive të fëmijës ndaj veprës së kryer, e që përveç dashjes ose pakujdesisë si sjellje psikologjike ndaj veprimit dhe pasojës së tij e manifeston papërshtatshmërinë e tij, braktisjen e arsimit ose zhvillimin devijant të personalitetit të tij.

Ligji për drejtësi për fëmijë i ndërmerr të gjitha zgjidhjet paraprake që kanë të bëjnë me personat e rritur të rinj, të cilët janë kufiri i kategorisë midis fëmijëve dhe kryerësve të rritur të veprave penale.

Edhe pse kjo kategori është e huaj për kuptimin, funksionet dhe qëllimet e sistemit të drejtësisë për fëmijë, bashkëngjitja e tij ndaj trajtimit të veçantë të fëmijëve me mundësinë e shqiptimit të masave edukative është pozitive meqë në këtë mënyrë hapet depërtim më i thellë i parimeve të individualizimit dhe risocializimit në vend të ritubimit, në fushën e sistemit të përgjithshëm juridiko penal.

Procedurat e konstatimit të ekzistimit të rrethanave relevante për shqiptimin e një mase të caktuar ndaj fëmijës në rrezik ose sanksion ndaj fëmijës në konflikt me ligjin janë rregulluar me respektimin e parimeve themelore të cilave u referohen edhe dokumentet ndërkombëtare për të drejtat e fëmijës: garanci procesuale, me të drejtë të detyrueshme për mbrojtje dhe avokim, specializim dhe kompetencë të organeve të cilat e zbatojnë masën ose e shqiptojnë sanksionin dhe respektim dhe mbrojtje të personalitetit të fëmijës ndaj çdo forme të veprimit ndaj tij nga institucionet kompetente, deinstitutionalizim të trajtimit dhe kohëzgjatje sa më të shkurtër të masave institucionale të cilat e nënkuptojnë privimin nga liria të fëmijës, të shfrytëzuar si mjet i fundit.

Kompleksi i dispozitave për mbrojtjen e fëmijëve-viktima të veprave penale dhe dhunës dhe të fëmijëve-dëshmitarë në procedurat penale e pasqyron qasjen integraliste, i cili mbështetet në faktin se me kategoritë e fëmijëve në konflikt me ligjin dhe fëmijëve në rrezik ata i bashkon ideja se elementi i viktimizimit dhe i mbrojtjes: bëhet fjalë për fëmijë të cilët kanë nevojë dhe të drejtë për mbrojtje, ndihmë dhe kujdes nga shoqëria, përmes përmbushjes së tyre ajo (shoqëria) siguron ardhmëri prosperitare. Në dispozitat e Ligjit për drejtësi për fëmijë janë garantuar të drejtat e këtyre dy kategorive dhe trajtimi i tyre në procedurën penale. Përveç garancive të veçanta të fëmijës-viktimë që i ka si i dëmtuar në procedurë, Ligji i rregullon të drejtat e posaçme të tij të mbrojtjes procesuale tek disa lloje të veprave penale ose kur ka nevojë për kujdes dhe mbrojtje të veçantë përmes përdorimit të masave të posaçme procesuale për mbrojtje dhe emergjencë të procedurës (neni 146-150). Posaçërisht është e rëndësishme se Ligji e përkufizon të drejtën e fëmijës-viktimë



të veprës penale ose kundërvajtjes të dhunës ose aktit tjetër të dhunës (konflikt i armatosur, demonstrata të dhunshme etj.), dëmshpërblim nga fondi i veçantë i formuar në kuadër të buxhetit të Ministrisë së Drejtësisë, nëse dëmshpërblimi nuk mund të kryhet nga kryerësi i veprës (neni 151- 152). Kjo dispozitë imperative e imponon obligimin për sigurimin e fondit të atillë në kuadër të buxhetit të Ministrisë së Drejtësisë dhe nëse i njëjti nuk sigurohet, atëherë paraqet bazë për ngritjen e padisë kundër shtetit për kompensimin e dëmit.

Mbrojtja e fëmijëve si viktime dhe si dëshmitarë në procedurën penale sigurohet në përputhje me dispozitat e Ligjit për procedurë penale dhe Ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe me zbatimin sipas nevojës të masave të posaçme për mbrojtjen e integritetit psikofizik të fëmijës.

Në një sistem të orientuar preventiv dhe protektiv, siç është sistemi i drejtësisë për fëmijë i zhvilluar me Ligjin për drejtësi për fëmijë, është e logjikshme të inkorporohet edhe segmenti jashtëzakonisht i rëndësishëm i parandalimit të delikuençës së fëmijëve. Ai është trajtuar në ligjin (në pjesën e gjashtë) si kornizë legislative për obligimet e shtetit ta organizoj sistemin e parandalimit përmes autoriteteve përkatëse siç është Këshilli Shtetëror dhe këshillat komunal për parandalim. Me përmbushjen e tyre shteti u bashkëngjitet praktikave të mira të shteteve të zhvilluara për formimin e autoriteteve të këtilla, si formë e përfshirjes së shoqërisë më të gjerë dhe shkencës në formulimin e qëllimeve kriminale – politike, mjeteve dhe instrumenteve për luftimin e delikuençës së fëmijëve.

1.2. Strategjia për Reformë të Jurisprudencës viti 2017-2022

Sistemi i drejtësisë për fëmijë është sanksionuar në Ligjin për drejtësinë e të miturve dhe i avancuar me Ligjin për drejtësi për fëmijë akoma ballafaqohet:

- me ekzistimin e kushteve të këqija materiale,
- mungesën e arsimit fillor dhe risocializimin sistematik të fëmijëve të privuar nga liria, kështu që sugjeron të ekzistoj kujdes më i madh dhe nevojë për përpjekje për fuqizimin plotësues të të drejtave të fëmijës.

Në Strategji konstatohet se akoma ka mosharmonizim të Ligjit për drejtësi për fëmijë me Ligjin e ri për procedurë penale dhe Ligjin për kundërvajtje si dhe me direktivat e BE-së.

Prandaj, theksohet se nevojiten ndryshime në Ligjin për drejtësi për fëmijë, në drejtim të:

- harmonizimit të tij me ligjet e tjerë dhe me direktivat e BE-së,



Projekti është financuar nga
Bashkimi Evropian

Partnership Justitia: Regaining Citizens' Trust
Партнерство Јустисија: Враќање на довербата на граѓаните
Partneriteti Justitia: Rikthimi i besimit të qytetarëve



Projekti është bashkëfinancuar
nga Qeveria e Republikës së
Maqedonisë së Veriut

- fuqizimit të mbrojtjes së fëmijëve-viktima të veprave penale,
- inkorporimit të dispozitave procedurale në lidhje me rrjedhën e seancës kryesore,
- lehtësimit të qasjes së fëmijëve-viktima deri te këshilla juridike dhe avokimi, dhe
- Formimit të Fondit për dëmshpërblimin e fëmijëve - viktima.

Ndryshimet duhet t'i përforcojnë edhe mekanizmat për parandalimin e delikuencës së fëmijëve në nivel lokal dhe qendror, si dhe përforcimin institucional, material dhe funksional të Këshillit Shtetëror për Parandalimin e Delikuencës së Fëmijëve.

1.3. Indikatorë për monitorimin e implementimin e Ligjit për drejtësi për fëmijë

Me mbështetjen e zyrës së UNICEF, ekspertë nacionalë përpiluan listë me 32 indikatorë për monitorimin e implementimit të Ligjit për drejtësi për fëmijë, për nevojat e Këshillit Shtetëror për Delikuencën e Fëmijëve të cilat i mbledhë nga 63 institucione të sistemit për drejtësi për fëmijë edhe atë 8 SPB, 30 QPS dhe 12 gjykata themelore me kompetencë të zgjeruar, 12 PTHP dhe një PTHP për ndjekjen e veprave penale nga krimi dhe korrupsioni i organizuar.

Të dhënat statistikore nga indikatorët, përpunohen në mënyrë statistikore dhe janë pjesë e Raportit vjetor të Këshillit Shtetëror për Delikuencën e Fëmijëve të cilin e miraton Kuvendi i RMV.

1.4. Indikatorë për monitorimin e gjendjes me fëmijët viktima të veprave penale

NKTZDZZ e përdor listën prej 43 indikatorëve ndërsa të dhënat grumbullohen nga 222 institucionet e sistemit të drejtësisë për fëmijë edhe atë nga 30 Qendra për punë sociale, 8 Sektorë për punë të brendshme të cilët përfshijnë 38 stacione policore, 133 institucione arsimore (shkolla fillore dhe të mesme), Qendra për shëndetin publikë - Shkup, 22 Prokurori Themelore Publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe një Prokurori Themelore Publike për Ndjekjen e Veprave Penale nga Krimi dhe Korrupsioni i Organizuar dhe 27 Gjykata themelore.



Projekti është financuar nga
Bashkimi Evropian

Partnership Justitia: Regaining Citizens' Trust
Партнерство Јуститија: Враќање на довербата на граѓаните
Partneriteti Justitia: Rikthimi i besimit të qytetarëve



Projekti është bashkëfinancuar
nga Qeveria e Republikës së
Maqedonisë së Veriut

Të dhënat e siguruara përmes indikatorëve në çdo fushë veç e veç, në mënyrë statistikore përpunohen nga anëtarët e autoritetit nacional, dhe e prezantojnë Raportin vjetor të cilin e miraton Qeveria e RMV.

1.5. Analizë komparative – propozime për ndryshimin e Ligjit për drejtësi për fëmijë.

Për këtë, por edhe për shkak të vërejtjeve nga kasta e ekspertëve, para së gjithash nga ekspertët e praktikës, ekspertët nacional të cilët një kohë më të gjatë punojnë në sistemin e drejtësisë për fëmijë konstatuan nevojë për ndryshimin e këtij ligji, i cili është specifikuar në Planin e Veprimit për implementimin e Strategjisë për Reformë të Sektorit të Jurisprudencës 2017-2022.

Janë identifikuar këto qëllime për ndryshimin e ligjit:

1. Respektim konsekuent të parimit - interesi më i mirë i fëmijës.
2. Harmonizim me direktivat e sapo miratuara të BE-së që kanë të bëjnë me garancitë procedurale për mbrojtjen e fëmijëve të cilët janë të pandehur ose të akuzuar në procedurë penale.
3. Fuqizimi i mbrojtjes së fëmijëve – viktimat të veprave penale, duke i përfshirë edhe masat e rehabilitimit dhe edukimit intensiv të fëmijëve.
4. Inkorporimi i dispozitave procedurale në lidhje me rrjedhën e seancës kryesore – dilema seancë kryesore ose seancë?
5. Të lehtësohet qasja e fëmijëve – viktimat deri te këshilla juridike dhe avokimi.
6. Krijimi i Fondit për dëmshpërblimin e fëmijëve viktimat.
7. Fuqizimi i mekanizmave për parandalimin e delikuencës së fëmijëve në nivel lokal dhe qendror, si dhe përforcimi institucional, material dhe funksional i Këshillit Shtetëror për Parandalimin e Delikuencës së Fëmijëve.
8. Rishikimi i parimeve themelore.
9. Avancimi i drejtësisë restorative – ndërmjetësimit dhe forma të tjera të anashkalimit të procedurës gjyqësore.
10. Rishikimi normativ i veprimit dhe rolit të qendrave për mbrojtje sociale.



Projekti është financuar nga
Bashkimi Evropian

Partnership Justitia: Regaining Citizens' Trust
Партнерство Јуститија: Враќање на довербата на граѓаните
Partneriteti Justitia: Rikthimi i besimit të qytetarëve



Projekti është bashkëfinancuar
nga Qeveria e Republikës së
Maqedonisë së Veriut

11. Ndryshime në pjesën materiale në lidhje me institucionet në të cilat ekzekutohen sanksionet ndaj fëmijëve.

12. Rregullimi normativ i Ndhmës juridike falas – përkatësisht kompensimi i avokatëve para QPS dhe policisë.

13. Inkorporimi i dispozitave procedurale në lidhje me rrjedhën e seancës verbale.

14. Rishikimi i dispozitave të cilat përmbajnë elementë restorativ me qëllim të tejkalimit të problemeve të identifikuara të cilët e pamundësojnë zbatimin e tyre më të shpeshtë.

15. Rishikimi i procedurave të cilat i ndërmarrin QPS dhe fuqizimi i autorizimeve të saj në lidhje me ekzekutimin e sanksioneve.

16. Avancimi i të Drejtave të fëmijëve - viktima.

17. Rishikimi i dispozitave në lidhje me kompetencën për ekzekutimin e sanksioneve.

18. Inkorporimi i dispozitave në lidhje me organikën institucionale EEK.

19. Lehtësimi i procedurës për dëmshpërblim.

20. Fuqizimi funksional i Këshillit Shtetëror dhe të mekanizmave për parandalimin e delikuencës së fëmijëve.

Gjithashtu, nevojitet Transponimi i direktivave relevante të BE-së:

- Direktiva BE 2016/800 e Parlamentit Evropian për garancitë procedurale të fëmijëve të pandehur ose të akuzuar në procedurë penale, përfshirë këtu edhe direktivat të cilat i thekson kjo Direktivë;
- Direktiva 2012/29 / BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit nga 25 tetori i vitit 2012 për përcaktimin e standardeve minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit dhe ndryshim të Vendimit Kuadër të Këshillit 2001/220 / JHA
- Direktiva 2013/48 / BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit nga 22 tetori i vitit 2013 për të drejtën e qasjes deri te avokati në procedurë penale dhe në procedura për fletë-arrestime evropiane, si dhe për të drejtën e personit të tretë që të informohet nga privimi nga liria dhe të komunikoj me persona të tretë dhe me organet konsullore përderisa është privuar nga liria;
- Direktiva 2010/64 / BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit nga 20 tetori i vitit 2010 për të drejtën e interpretimit dhe përkthimit në procedurën penale;
- Direktiva 2012/13 / BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit nga 22 maj të vitit 2012 për të drejtën e informacioneve në procedurën penale;
- Direktiva (BE) 2016/343 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit nga 9 maji i vitit 2016 për përforcimin e aspekteve të caktuara të prezumimit të pafajësisë dhe të drejtës të marrin pjesë në gjykimin për procedura penale;



Projekti është financuar nga
Bashkimi Evropian

Partnership Justitia: Regaining Citizens' Trust
Партнерство Јуститија: Враќање на довербата на граѓаните
Partneriteti Justitia: Rikthimi i besimit të qytetarëve



Projekti është bashkëfinancuar
nga Qeveria e Republikës së
Maqedonisë së Veriut

- Direktiva (BE) 2016/1919 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit nga 26 tetori i vitit 2016 për ndihmë juridike për personat e pandehur dhe të akuzuar në procedurë penale dhe për persona të lutur në procedurat e fletë arresteve në Evropë.

ANEKSI 2

Mr. Olja Ristova
Gjyqtare në Gjykatën Themelore Penale Shkup

data 11.12.2019

Ligji për procedurë penale

10. Rekomandohet të inkorporohet praktika sipas së cilës prokurori publik do ta ketë për detyrë të gjitha provat t'ia paraqes mbrojtjes në fillim të procedurës. Edhe pse ky obligim nuk rezulton nga Ligji për procedurë penale, i njëjti rezulton nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe nënshkruara nga Republika e Maqedonisë së Veriut të cilat janë pjesë përbërëse të legjislacionit vendor.
11. Rekomandohet qasja drejt propozimit për ujdj të fajit çdoherë kur prokuroria ka në dispozicion prova të fuqishme për lëndën.
12. Ndryshimi i dispozitave të Ligjit për procedurë penale në pjesën e procedurës së shkurtuar, me qëllim të njoftimit të detyrueshëm të të akuzuarit kur ka filluar hetimi ose kur grumbullohen provat.
13. Ndryshime ligjore në drejtim të regjistrimit të seancave gjyqësore pa obligim për dhënien e procesverbalit.
14. Fuqizimi i kapaciteteve të gjykatave përmes punësimit të një numri më të madh të bashkëpunëtorëve dhe nëpunësve profesionistë, me qëllim të ngritjes së kualitetit të punës së gjyqtarëve.
15. Kontrolli dhe detektimi i problemeve kryesore për shkak të të cilave prolongohen seancat gjyqësore dhe në këtë bazë të realizohet trajnim për gjyqtarët për menaxhimin e lëndëve me qëllim të efikasitetit gjatë veprimit.
16. Përforcimi i menaxhmentit të gjykatave në drejtim të shpërndarjes së drejtë të gjyqtarëve dhe shërbimeve gjyqësore nëpër departamente, me qëllim të rritjes së efikasitetit gjatë veprimit me lëndët.



Projekti është financuar nga
Bashkimi Evropian

Partnership Justitia: Regaining Citizens' Trust
Партнерство Јустисија: Враќање на довербата на граѓаните
Partneriteti Justitia: Rikthimi i besimit të qytetarëve



Projekti është bashkëfinancuar
nga Qeveria e Republikës së
Maqedonisë së Veriut

17. Avancim i rregullt i sistemit AKMIS në përputhje me nevojat e përditshme të të gjithë shfrytëzuesve të këtij sistemi.
18. Anëtarët e Këshillit Gjyqësor të kenë komunikim të vazhdueshëm me gjyqtarët e gjykatave për të cilët janë kompetentë, me qëllim që në mënyrë të drejtë t'i konstatojnë problemet e gjyqtarëve të cilat ndikojnë në vlerësimin e punës së tyre.
19. Rekomandohet revalorizimi i punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve publik, në vend të Vetingut i cili do ta përfshijë stazhin e përgjithshëm të gjyqtarëve/prokurorëve dhe të njëjtin do ta zbatonin persona profesionistë dhe të pavarur të cilët posedojnë njohuri të padiskutueshme për mënyrën e veprimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë.

Kodi Penal

1. Rekomandohet të miratohet Udhëzim për unifikimin e praktikës gjyqësore për përcaktimin e llojit dhe lartësisë së sanksionit penal.
2. Trajnim intensiv për gjyqtarët për zbatimin e Ligjit për shërbimin e provës, meqë bashkëpunimi me shërbimin e provës mundëson qasje të drejtë në drejtim të individualizimit të dënimit për çdo të akuzuar.
3. Ndryshime të dispozitave për mbikëqyrje të mbrojtur në Kodin Penal, në drejtim të rritjes së llojit të masave të cilat do t'i shqiptoj gjykata, me qëllim të reduktimit të numrit të recidivistëve.

ANEKSI 3

Mr. Antoaneta Dimovska, gjyqtare në Gjykatën Themelore Civile

Reforma në të drejtën civile

Zgjedhja e gjyqtarëve me integritet, kredibilitet dhe njohuri.



Projekti është financuar nga
Bashkimi Evropian

Partnership Justitia: Regaining Citizens' Trust
Партнерство Јуститија: Враќање на довербата на граѓаните
Partneriteti Justitia: Rikthimi i besimit të qytetarëve



Projekti është bashkëfinancuar
nga Qeveria e Republikës së
Maqedonisë së Veriut

Ky është parakushti i parë për cilëndo qoftë reformë në sistemin gjyqësor, pa një gjë të këtillë nuk do të ketë kualitet në sistemin gjyqësor dhe çdo gjë tjetër që do të propozohet do të ishte e parëndësishme. Megjithatë, është fakt se ka një numër të madh të gjyqtarëve të cilët me përkushtim e kryejnë punën e tyre dhe gjatë gjithë kësaj periudhe u rezistojnë ndikimeve të ndryshme dhe tentativave që të diskreditohen.

Duke e pasur parasysh praktikën gjyqësore nga pavarësia e Republikës së Maqedonisë së Veriut e deri më sot mund të konstatohet si vijon:

Pushuan së funksionuari Gjykatat e punës së bashkuar të cilat ishin kompetente për kontestet e punës, kështu që në vitin 1996 u bë një reformë e madhe me suspendimin e Gjykatave Ekonomike Rajonale dhe Gjykatës Ekonomike të Republikës së Maqedonisë. Me këtë reformë u themeluan Gjykatat themelore si gjykata të shkallës së parë, Gjykatat e Apelit në Shkup, Manastir, Shtip dhe Gjykata Supreme. Më vonë u themelua Gjykata Administrative dhe Gjykata e Lartë Administrative, si dhe Gjykata e Apelit në Gostivar.

E gjithë kjo kontribuoi të ketë ngecje në punën e lëndëve e që është një moment objektiv dhe u dëshmuar se reforma nuk kishte mbështetje në aspektin personal dhe teknik e që ndikoi akoma më shumë në ngecjen e punës. Së këtejmi, gjykatave themelore iu bart kompetenca e përgjithshme gjatë veprimit në shkallë të parë, pa u ekipuar në aspektin hapësinor, personal dhe teknik.

Kjo situatë vazhdoi edhe në periudhën e ardhshme e deri më sot.

1. Gjykatat nuk kanë pajisje teknike duke i pasur parasysh obligimet që i kanë në përputhje me ligjin dhe nuk janë të ekipuara në aspektin hapësinor dhe personal.

2. Ndryshime në ligjin për procedurë kontestimore.

Ligji për procedurë kontestimore e inkorporoi si detyrimore regjistrimin tonik nga seancat e mbajtura, por jo vetëm që gjykatat nuk janë plotësisht të pajisura teknikisht por edhe pajisja e instaluar në pjesën më të madhe të sallave të gjyqit nuk funksionon dhe nuk është adekuate. Kjo pajisje nuk është parashikuar të punojë aq orë pune dhe me kapacitet të atillë siç punon.

Ligji për procedurë kontestimore nga viti 2005 bëri ndryshime pozitive në aspekt të përshpejtimit të procedurave dhe braktisjes së parimit hetues, me ç'rast nuk u trajtua obligimi i gjykatës që në mënyrë të drejtë ta konstatoj gjendjen faktike.

Me ndryshimet e LPK nga viti 2010, 2011 dhe nga viti 2005 ligjit pësoi ndryshime të cilat nuk e përmirësuan kualitetin e tij por sipas mendimit të ekspertëve të cilët e trajtojnë të drejtën civile bëri hapa retrograd sa i përket cilësisë së ndarjes së drejtësisë.

Shkak për këtë janë ndryshimet si vijnë:



Projekti është financuar nga
Bashkimi Evropian

Partnership Justitia: Regaining Citizens' Trust
Партнерство Јустисија: Враќање на довербата на граѓаните
Partneriteti Justitia: Rikthimi i besimit të qytetarëve



Projekti është bashkëfinancuar
nga Qeveria e Republikës së
Maqedonisë së Veriut

Ekspertiza konform ndryshimeve të Ligjit për procedurë kontestimore nga viti 2010 në nenin 235 paragrafi 1, përcakton se gjykata do të nxjerr akt-ekspertizë si provë, nëse pala me padinë ose përgjigjen e paraqet gjetjen ose opinionin profesional të ekspertit mjeko ligjor.

Kjo dispozitë ligjore është në kundërshtim të plotë me të gjitha dispozitat që kanë të bëjnë me provat, fazën e propozimit të tyre dhe në kundërshtim me qëllimin për shkak të të cilit nxirret prova.

Me fjalë të tjera, prova akt-ekspertiza nxirrej në përputhje me nenin e deriatëhershëm 235, kur për shkak të përcaktimit ose zgjidhjes të ndonjë fakti nevojitet njohuri profesionale të cilën gjykata nuk e posedon. Kjo zgjidhje ligjore e shpreh plotësisht esencën e provës akt-ekspertizë. Ndryshimet në nenin 235 paragrafin 1 plotësisht e ndryshoi esencën, kuptimin dhe rëndësinë e provës akt-ekspertizë.

Pala, para së gjithash, që në momentin e paraqitjes së padisë “duhet ta dijë” cilat fakte do të jenë kontestuese për të paditurit dhe cilat jo. Kështu që, për shembull, nëse bëhet fjalë për padi për kompensim të dëmit, paditësi do të duhet të përpiloj akt-ekspertizë komunikacioni meqë nuk mund ta dijë nëse i padituri do ta kontestoj se i kujt është faji për rastin e aksidentit në komunikacion edhe pse ndoshta para paraqitjes së padisë kjo nuk ka qenë fare kontestuese. Nga ana tjetër, i padituri do të paraqes akt-ekspertizë me përgjigjen e padisë ose gjykata sipas nenit 235 paragrafi 2 do të përcaktoj ekspertizë me urdhër të shkruar, nëse besohet se ekzistojnë fakte ose rrethana për shkak të të cilave nuk mund të siguroj gjetje dhe mendim nga eksperti mjeko ligjor.

T’i referohemi esencës se çka në të vërtetë do të thotë ekspertizë. Ekspertët mjeko ligjor janë mjet prove, ndërsa ekspertiza është funksion (veprimtari, punë, detyrë) e ekspertit. Eksperti mjeko ligjor është person i cili posedon njohuri profesionale nga një fushë e caktuar të cilat njohuri gjykata nuk i posedon. Ekspertiza përfundon me gjetje dhe opinion, por nuk do të thotë që çdoherë të jetë kështu. Me fjalë të tjera, mund të bëhet fjalë për ekspertizë komplekse, kështu që një person ekspert mjeko ligjor mund të ofroj gjetje, përkatësisht t’i konstatoj faktet, ndërsa një person tjetër ekspert mjeko ligjor të jap opinion.

Gjykata në përputhje me ligjin çdo provë e vlerëson veç e veç dhe të gjitha provat bashkërisht, që do të thotë se gjykata mund të konstatoj gjendje të ndryshme faktike nga ajo që e ka dhënë eksperti mjeko ligjor, pikërisht duke e shfrytëzuar akt-ekspertizën. Për shembull, eksperti mjeko ligjor në detaje e ka përshkruar kush, ku ka lëvizur, çfarë veprimi ka ndërmarrë në një moment të caktuar, por ka ardhur në përfundim të gabueshëm se i padituri është fajtor për rastin e aksidentit në komunikacion, meqë veprimin të cilin e ka ndërmarrë ai është në kundërshtim me ligjin. Konkretisht, i padituri ka vozitur me shpejtësi të lejuar, ka reaguar në kohë ndaj aksidentit në komunikacion, por në momentin përkatës ka qenë nën ndikimin e alkoolit dhe prandaj eksperti mjeko ligjor ka konstatuar se ai është fajtor për aksidentin në komunikacion rrugor.

T’i kthehemi temës në fjalë. Pse zgjidhja aktuale ligjore sa i përket ekspertizës është në kundërshtim me esencën e saj. Meqë ekspertiza nevojitet atëherë kur gjykata nuk ka njohuri nga



ndonjë fushe të caktuar, ndërsa zgjidhja aktuale ligjore nënkupton se pala duhet të supozoj se cilat fakte gjykata nuk mund t'i konstatoj pa ekspertizë. Braktisja e këtij përkufizimi në ligj nuk e ndryshon esencën e ekspertizës. Ajo mbetet e njëjtë, megjithatë ligji e anulon plotësisht.

Nga ana tjetër, me obligimin e palëve që padisë t'ia bashkëngjisin akt-ekspertizën, përkatësisht me përgjigjen ndaj padisë që në fillim këtë provë e vë në një pozitë ndryshe nga provat e tjera të cilat mund të propozohen edhe në seancën përgatitore. Është në kundërshtim edhe me vet esencën e seancës përgatitore në të cilën shqyrtohen pikërisht faktet kontestuese dhe për këto fakte kontestuese palët propozojnë prova. Nëse në seancën përgatitore palët arrijnë marrëveshje se ndonjë fakt nuk është kontestues, atëherë akt-ekspertiza që i është bashkëngjitur padisë pikërisht për konstatimin e atij fakti është absolutisht e panevojshme.

Zgjidhja ligjore e nenit 235 paragrafi 2 të LPK nëse pala beson se ekzistojnë fakte ose rrethana për shkak të të cilave nuk mund ta siguroj gjetjen dhe opinionin nga eksperti mjeko ligjor, gjykata do të përcaktoj ekspertizë me urdhër të shkruar provat e akt-ekspertizës i vë në “pozitë të pabarabartë”.

Konkretisht kur njëra palë paraqet akt-ekspertizë ajo vet i përcakton drejtimet se cilat fakte duhet të konstatohen, ndërsa nëse gjykata urdhëron të bëhet ekspertizë, gjykata gjithmonë do t'i jap detyrë ekspertit mjeko ligjor se mbi cilat rrethana duhet të përpilohet akt-ekspertiza. Gjithsesi se gjykata në urdhrin e saj çdoherë mund të kërkoj nga eksperti mjeko ligjor gjetje dhe opinion edhe për rrethanën për të cilën gjykata konsideron se duhet të konstatohet. Kjo e vë në pikëpyetje parimin e barazisë së palëve.

Do të vihet në pikëpyetje edhe paanshmëria e ekspertit mjeko ligjor i cili e përpilon akt-ekspertizën me kërkesë të palës, për dallim nga ekspertiza të cilën e urdhëron gjykata. Gjithsesi se shumëkush do të thotë se vihet në lojë integriteti i ekspertit mjeko ligjor, megjithatë praktika gjyqësore e mohon një gjë të këtillë. Për çdo ditë ballafaqohemi me akt-ekspertiza të cilat i paraqesin palët dhe të cilat janë diametralisht të kundërta. Lirisht mund të konkludohet se akt-ekspertizat në të shumtën e rasteve bëhen sipas dëshirës së palëve dhe se super-ekspertiza përpilohet thuaja se për çdo lëndë. Kur themi se akt-ekspertiza përpilohet sipas dëshirës së palës, kjo nuk do të thotë se pala insiston që të përpilohet në atë mënyrë që nga e njëjta të konstatohen fakte të cilat shkojnë në favor të paditësit ose të paditurit varësisht nga ajo se kush e ka kërkuar ekspertizën. Eksperti mjeko ligjor në mënyrë të “natyrshme” konkludon se duhet të përpilohet akt-ekspertizë. Kjo sërish konfirmohet me faktin e ekzistimit të akt-ekspertizave diametralisht të kundërta për gjendje të njëjtë faktike. Megjithatë, shumica do të thonë se eksperti mjeko ligjor e ka dhënë vetëm opinionin e tij, meqë ai ashtu i percepton punët, por kjo thjeshtë nuk është ashtu. Nevoja për numër kaq të madh të super ekspertizave e vë në dukje konkluzionin se kohëve të fundit mungojnë kuadro profesional të cilët do të përpilojnë akt-ekspertiza cilësore. Megjithatë përvoja edhe e gjyqtarëve por edhe avokatëve me të cilët për çdo ditë diskutojmë në këtë temë janë thuaja se unison se bëhet fjalë për akt-ekspertiza të përpiluara “sipas dëshirës” së palëve, përkatësisht sipas mendimit të ekspertëve mjeko ligjor se akt-ekspertizën duhet ta përpiloj në atë mënyrë që të jetë në dobi të palës e cila e kërkon përpilimin e akt-ekspertizës.

Mosdhënia e drejtimeve nga gjykata në lidhje me rrethanat për të cilat përpilohet akt-



Projekti është financuar nga
Bashkimi Evropian

Partnership Justitia: Regaining Citizens' Trust
Партнерство Јуститија: Враќање на довербата на граѓаните
Partneriteti Justitia: Rikthimi i besimit të qytetarëve



Projekti është bashkëfinancuar
nga Qeveria e Republikës së
Maqedonisë së Veriut

ekspertiza e bart me vete rrezikun që ekspertët mjeko ligjorë “ta miratojnë aktgjykimin”. Ta marrim përsëri për shembull akt-ekspertizën në komunikacion. Thuaja se pa përjashtim çdo akt-ekspertizë në të cilën eksperti mjeko ligjor gjen kontribut për secilin nga pjesëmarrësit në aksidentin e komunikacionit përfundon me konkluzion se cili, me sa përbindje, ka marr pjesë në aksidentin rrugor. Madje edhe nëse pala tjetër paraqet akt-ekspertizë në të cilin janë konstatuar lëshime identike nga aspekti i komunikacionit, konkluzioni është i ndryshëm në lidhje me përbindjet e dhëna. Një gjë e këtillë është e patolerueshme. Nuk mund të anashkalohet fakti edhe kur gjyqtarët marrin vendim për ekspertizë disa prej gjyqtarëve insistonin që ekspertët mjeko ligjor ta përcaktojnë edhe përbindjen, e që nënkupton që ta marrin edhe vendimin. Megjithatë, kjo nuk e arsyeton zgjidhjen aktuale ligjore.

Me paraqitjen e akt-ekspertizës bashkë me padinë ose me përgjigjen ndaj padisë nuk ekziston mundësia që të eliminohen edhe rastet në të cilat eksperti mjeko ligjor duhet të përjashtohet, meqë në shumë raste eksperti mjeko ligjor nuk është i njoftuar për ekzistimin e shkaqeve të cilat mund të çojnë deri në përjashtimin e tij. E gjithë kjo mund të evitohet nëse gjykata lëshon urdhër për ekspertizë.

Problemet me ekspertizën në përgjithësi

Duhet të theksohen edhe disa probleme në lidhje me ekspertizën të cilët janë të pranishëm në praktikën gjyqësore vite me radhë, pavarësisht nëse përpilimi i akt-ekspertizës përcaktohet nga gjykata ose me kërkesë të palës.

Problemi i parë ka të bëjë me mos detektimin e çështjeve kontestuese, nga aspekti i asaj nëse të njëjtat janë kontestuese si çështje faktike ose juridike.

Shpeshherë nga ekspertët mjeko ligjor kërkohet të përgjigjen për çështje juridike, që jo vetëm nuk është e lejuar por është në kundërshtim edhe me ligjin.

Ndodhë që gjykata të parashtroj pyetje nëse paditësi ka të drejtë “diçka t’i takoj atij”, “nëse i padituri ka ndonjë borxh” dhe ngjashëm. Në momentin kur palët e paraqesin akt-ekspertizën kjo gjë thuaja se është rregull. Gjyqtari me sa duket fiton zëvendësim tek eksperti mjeko ligjor.

Nga aspekti i veprimit të gjykatës, faza në të cilën detektohen çështjet kontestuese është seanca përgatitore. Të njëjtën gjykata duhet ta mbaj në mënyrë që t’i nxisë palët t’i nxjerrin të gjitha faktet vendimtare dhe të propozojnë prova me qëllim të konstatimit të të njëjtave. Kjo do të thotë se seanca përgatitore assesi nuk duhet të nënkuptohet se mbetet vetëm padia dhe përgjigjja ndaj padisë, por në mënyrë esenciale duhet të “shqyrtohen” të gjitha aspektet e kontestit, për këtë gjykata duhet të përgatitet mirë por edhe palët, përkatësisht të autorizuarit e tyre. Në këtë fazë duhet të hapen edhe çështjet juridike nga shqyrtimi i të cilave do të varet edhe propozimi i provave.

Super ekspertiza si zgjidhje ligjore

Superekspertiza si zgjidhje ligjore po ashtu është problematike. Në përputhje me nenin 246 paragrafin 2 të LPK kur të dhënat e ekspertëve mjeko ligjor për gjetjen e tyre nuk korrespondojnë



esencialisht, ose gjetja e njërit apo të më shumë ekspertëve mjeko ligjor nuk është e qartë, është e paplotë ose është në kundërshtim me vetveten ose me rrethanat e realizuara, ndërsa këto mangësi nuk mund të shmangen me seancë të sërishme dëgjimore të ekspertëve mjeko ligjor, gjykata mund të përcaktoj superekspertizë e cila do të realizohet në afatet e përcaktuara në nenin 245 paragrafi 1 të LPK.

Zbatimi i kësaj dispozite nënkupton se gjykata mundet por nuk është e domosdoshme të përcaktoj superekspertizë. Para së gjithash, vet terminologjia ligjore është inkoherente meqë në rastin e nenit 235 parafi 2 i ligjit operon me nocionin urdhërojë, ndërsa në këtë rast përcaktoj. Kjo inkoherencë gjatë përdorimit të terminologjisë ndoshta edhe nuk shkakton probleme aq sa shkakton problem jopreciziteti i kësaj dispozite dhe kjo është se “gjykata mund të përcaktoj superekspertizë”.

Parashtrohet pyetja në ç’ mënyrë gjykata do të vendos a do të përcaktoj superekspertizë ose jo kur e njëjta përcaktohet në rastin kur të dhënat e ekspertëve mjeko ligjor për gjetjen e tyre nuk korrespondojnë në mënyrë esenciale, ose gjetja e njërit ose të më shumë ekspertëve mjeko ligjor nuk është e qartë, është i paplotë ose është në kundërtënie me vetveten ose me rrethanat e analizuara, ndërsa këto mangësi nuk mund të shmangen me seancë të sërishme dëgjimore të ekspertëve mjeko ligjor. A do të thotë kjo se gjykata mund të pranoj ndonjë akt-ekspertizë si provë nga e cila mund të konstatohen faktet relevante juridike, meqë e njëjta është e logjikshme, e përpiluar në bazë të fakteve dhe provave autentike dhe ngjashëm, ndërsa akt-ekspertiza tjetër nuk është përpiluar në këtë mënyrë. Megjithatë, praktika dëshmon se në 100% të rasteve kur akt-ekspertizat në mënyrë esenciale nuk korrespondojnë atëherë gjykata përcakton superekspertizë. Aq më shumë se palët të cilat i kanë paraqitur akt-ekspertizat propozojnë gjykata të mos përpiqet t’i harmonizoj meqë paraprakisht e dinë se ekspertët mjeko ligjor nuk do të dakordohen. Në të vërtetë një gjë të këtillë e dinë çdo gjyqtarë nga përvoja personale.

Superekspertiza hap çështje të njëjta si edhe akt-ekspertiza e cila përcaktohet me urdhër të gjykatës konform nenit 235 paragrafi 2 të LPK, dhe kjo ka të bëjë me atë nëse me superekspertizën përsëri nuk do të vijmë në situatë që gjykata të kërkoj nga eksperti mjeko ligjor të prononcohet edhe për rrethanat për të cilat gjykata konsideron se duhet të prononcohet. Gjithsesi se gjykata kur e përcakton superekspertizën përveç rrethanave për të cilat palët kanë kërkuar ekspertizë mund të kërkoj nga eksperti mjeko ligjor të prononcohet edhe për rrethana të tjera. Kjo është kështu meqë ligji nuk e ndalon një gjë të këtillë, ndërsa nga ana tjetër gjykata e ka për detyrë të kujdeset që të shqyrtohen të gjitha çështjet kontestuese, ndërsa në rastin konkret bëhet fjalë për çështje për të cilat gjykata nuk ka njohuri profesionale.

Tani përsëri kthehemi në fillim se megjithatë gjykata mund të urdhëroj ekspertizë dhe të “gjurmoj pas të vërtetës” por për një gjë të këtillë duhet “të krijohen” presupozime. Me fjalë të tjera, palët duhet të paraqesin dy akt-ekspertiza në të cilat ekspertët mjeko ligjor esencialisht nuk pajtohen me gjetjet e tyre, ose gjetja e njërit ose të më shumë ekspertëve mjeko ligjor është e paqartë, e paplotë ose është në kundërshtim me vetveten e tij ose me rrethanat e analizuara, ndërsa këto mangësi nuk mund të shmangen me seancë të sërishme dëgjimore të ekspertëve mjeko ligjor.

Këqyrja si zgjidhje ligjore e cila është problematike



Projekti është financuar nga
Bashkimi Evropian

Partnership Justitia: Regaining Citizens' Trust
Партнерство Јустисија: Враќање на довербата на граѓаните
Partneriteti Justitia: Rikthimi i besimit të qytetarëve



Projekti është bashkëfinancuar
nga Qeveria e Republikës së
Maqedonisë së Veriut

Kjo që u theksua më lartë thuaja se plotësisht ka të bëjë edhe me provën këqyrje. Neni 212 i LPK përcakton se këqyrja ndërmerret vetëm me propozim të palës kur për përcaktimin e ndonjë fakti apo për sqarim të ndonjë rrethane nevojitet shënimi i drejtpërdrejt i gjykatës. Këqyrja mund të bëhet edhe me pjesëmarrjen e ekspertëve mjeko ligjor të cilët i angazhon pala e cila e ka propozuar këqyrjen.

Konkretisht çka do të thotë kjo?

Se pala është ajo e cila e dinë se a i nevojitet gjykatës shënim i drejtpërdrejt që është absurd, ndërsa që absurdi të jetë akoma më i madh pala është ajo e cila e dinë se krahas shënimit të drejtpërdrejt gjykatës a i nevojitet ndihmë nga eksperti mjeko ligjor.

Pa marrë parasysh se parimi i hetimit është braktisur, këqyrja është provë për të cilën gjykata duhet të vendos se a do ta nxjerr edhe atë vet ose në prezencë të ekspertit mjeko ligjor. Kjo për një shkak të thjeshtë meqë vetëm gjykata e dinë se a i nevojitet shënim i drejtpërdrejt ose jo.

Gjithsesi se pala mund të propozojë këqyrje, gjykata do të prononcohet se a i nevojitet ose jo, dhe pikërisht për shkak të faktit se vetëm ajo e dinë se a ka nevojë për një gjë të këtillë ose jo.

Shkaqet e ndryshimit të Ligjit për procedurë kontestimore në pjesën e ekspertizës

Secili që për çdo ditë e praktikon Ligjin për procedurë kontestimore e dinë se ndryshimet e Ligjit për procedurë kontestimore nga viti 2010 kur u ndryshua kapitulli XXVII në pjesën e provave, këqyrje dhe ekspertizë e dinë se me këto ndryshime synohej të arrihet përshpejtimi i procedurave gjyqësore.

A u arrit kjo?

Absolutisht jo. Fillimisht një numër i madh i lëndëve përfundojnë me superekspertizë, por para kësaj ka faza të tjera të procedurës të cilat nuk zhvillohen edhe aq “shpejtë”. Kur i padituri do ta pranoj padinë nëse në të njëjtën ka akt-ekspertizë më së shpeshti menjëherë i drejtohet ekspertit mjeko ligjor për përpilimin e akt-ekspertizës dhe thuaja se në 100% të rasteve afatin të cilin e ka caktuar gjykata për paraqitjen e padisë nuk mjafton që të paraqitet përgjigje ndaj padisë me akt-ekspertizë. Atëherë, i padituri do të paraqes përgjigje ndaj padisë dhe provë se i është drejtuar ekspertit mjeko ligjor të përpiloj akt-ekspertizë por e njëjta nuk është përpiluar për shkak të afatit të shkurtër. Nga ana tjetër, gjykata e obliguar me afatet nga neni 271 të LPK e ka për detyrë në afat prej 8 ditësh të caktoj seancë përgatitore dhe e njëjta duhet të mbahet në afat prej 50 ditësh llogaritur nga dita e caktimit. Kjo do të thotë se gjykata dhe palët paraprakisht e dinë se me siguri akt-ekspertiza do të paraqitet fill para seancës përgatitore ose gjatë seancës përgatitore e që gjithsesi çon deri në prolongimin e seancës.

Pas pranimit të akt-ekspertizës të paraqitur nga i padituri, paditësi do të bëjë vërejtje ashtu siç i bën i padituri ndaj akt-ekspertizës të paraqitur nga paditësi. Varësisht nga ajo se kur është pranuar akt-ekspertiza nga ana e të paditurit, atëherë do të bëhen edhe vërejtjet për të cilat gjithsesi



Projekti është financuar nga
Bashkimi Evropian

Partnership Justitia: Regaining Citizens' Trust
Партнерство Јуститија: Враќање на довербата на граѓаните
Partneriteti Justitia: Rikthimi i besimit të qytetarëve



Projekti është bashkëfinancuar
nga Qeveria e Republikës së
Maqedonisë së Veriut

se duhet të prononcohet paditësi. Prononcimi më së shpeshti do të thotë konsultim me ekspertin mjeko ligjor i cili e ka përpiluar akt-ekspertizën e tij, ndërsa kjo nuk nënkupton se do t'i respektoj afatet në cilat gjykata i cakton seancat e që përsëri rezultojnë me prolongim të ri.

Pasi të bëhen vërejtjet gjykata do të përpiqet t'i harmonizoj ekspertët mjeko ligjor për çka nevojitet seancë dëgjimore ose prononcim me shkrim. Varësisht nga ajo se ekspertët mjeko ligjor a do t'i parashtrijnë në kohë prononcimet e tyre sipas vërejtjeve do të varet nga ajo nëse gjykata do të mbaj seancë ose jo.

Në fund nëse ekspertët mjeko ligjor nuk e ndryshojnë mendimin nga gjetjet dhe opinionet e tyre fillestare, atëherë gjykata mund të përcaktoj superekspertizë për të cilën thamë se përcaktohet thuaja se pa përjashtim. Nëse bëjmë një përllogaritje në vija të trasha katër seanca përgatitore do të prolongohen për shkak të ekspertizës.

Nëse gjykata e përcakton ekspertizën kjo do të bëhet në seancën e parë përgatitore. Kjo meqë në seancën përgatitore palët do të prononcohen për atë se cilat fakte janë kontestuese, gjykata me parashtrimin e pyetjeve dhe me stimulimin e palëve t'i nxjerrin të gjitha faktet vendimtare dhe të propozojnë prova, do të konstatoj cilat fakte janë kontestuese dhe për konstatimin e të cilave gjykata nuk posedon njohuri të nevojshme, kështu që do të jetë e nevojshme ekspertiza.

Probleme në lidhje me kontestet me vlerë të vogël në përputhje me zgjidhjen aktuale ligjore:

Në përputhje me zgjidhjen aktuale ligjore kontest me vlerë të vogël si në seancën e rregullt ashtu edhe në kontestet ekonomike janë konteste që kanë të bëjnë me kërkesën monetare e cila nuk është më e lartë se 600.000,00 denarë.

Është e pajustificueshme që kjo shumë të jetë e njëjtë edhe për kontestin ekonomik edhe për seancën e rregullt duke e pasur parasysh faktin se në kontestet civile duke e pasur parasysh fuqinë financiare të qytetarëve kjo shumë në asnjë mënyrë nuk mund të jetë kontest me vlerë të vogël. Personalisht e di se ndryshimet që u bënë në vitin 2005 në lidhje me vlerën e kontestit me vlerë të vogël siç u tha nga Ministria e Drejtësisë janë bërë sipas sugjerimit të Bakës Botërore me qëllim të përshpejtimit të procedurave. Kjo do të thotë se këto ndryshime jo vetëm që nuk ishin të nevojshme por me asgjë nuk u justifikuan. Nëse e kemi parasysh se në asnjë vend të Evropës shuma prej 10.000 euro nuk paraqet shumë e cila e kualifikon kontestin si kontest me vlerë të vogël.

Shkaku i dytë, me këto ndryshime u lejua ankesë ndaj gjendjes faktike që këtë kontest e barazoi tërësisht me seancën e rregullt, ndërsa ngeli dispozita se nuk mbahet seanca përgatitore por menjëherë caktohet seanca kryesore, gjë që çoi në procedurë tejet konfuze.

Pjesa e urdhërpagesës gjyqësore dhe e vendimmarrjes sipas kundërshtimit të urdhërpagesës noteriale:



Projekti është financuar nga
Bashkimi Evropian

Partnership Justitia: Regaining Citizens' Trust
Партнерство Јустисија: Враќање на довербата на граѓаните
Partneriteti Justitia: Rikthimi i besimit të qytetarëve



Projekti është bashkëfinancuar
nga Qeveria e Republikës së
Maqedonisë së Veriut

Me ndryshimet e Ligjit për noterinë u korigjua zgjidhja me të cilën kreditori mund të paraqes propozim për miratimin e vendimit për lëshimin e urdhërpagesës noteriale vetëm përmes personit të autorizuarit - avokat, por nuk u rregullua plotësisht zgjidhja kundër kushtetuese edhe për debitorin për të cilin akoma qëndron kundërshtimi kundër urdhërpagesës noteriale të jetë i detyruar ta paraqes përmes personit të autorizuar - avokat.

Kapitulli i cili ka të bëjë me procedurën e kundërshtimit kundër urdhërpagesës noteriale akoma nuk është përpunuar mjaftueshëm dhe ka mosharmonizim në vet Ligjin për noteri në pjesën e kryerjes së dërgesës në Ligjin për procedurë kontestimore.

3.E drejta materiale

Duke e pasur parasysh se ka filluar procesi i kodifikimit të së drejtës civile, proces i cili është shumë voluminoz dhe afatgjatë duhet të bëhen përpjekje që të veprohet në vazhdimësi, meqë duke e marrë parasysh se miratohen ligje të reja nëse nuk ndiqen ndryshimet një pjesë e madhe e punës do jetë pa efekt dhe akoma më shumë do të zvarritet i tërë procesi. Në këtë moment problem më i madh është mosharmonizimi i ligjeve materiale të cilët nga aspekte të ndryshme e trajtojnë problemin e njëjtë. Është e domosdoshme një analizë e detajuar e ligjeve sipas grupeve, me qëllim të përcaktimit të jokonsekuencave të theksuara.

4.Monitorimi i praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Trajnim i vazhdueshëm për të gjithë gjyqtarët sa i përket aspektit të GJEDNJ, për shkak se vendimet janë burimi i të drejtës. Përfshirja e detyrueshme e të gjithë gjyqtarëve të cilët punojnë në materien civile. Trajnim për ligjëruesit të cilët punojnë në Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publik në lidhje me praktikën e GJEDNJ.

Çdo gjë që është theksuar është vetëm pikë referente për reformat në të drejtën civile të cilat nëse fillojmë t'i zbatojmë seriozisht do të tregojnë se sa gjëra në të vërtetë do të duhet të ndryshojmë. Megjithatë, vullneti për reforma dhe fillimi është shumë i rëndësishëm, ndërsa personalisht unë konsideroj se kemi vullnet por vetëm duhet të bëhet përzgjidhja e njerëzve të cilët do të jenë udhëheqës të reformës në të cilën të gjithë ne që jemi pjesë të sistemit të jurisprudencës do të marrim pjesë në mënyrë aktive. Kjo është detyra jonë dhe prandaj nuk duhet të diskutohet.

Zbatimi i çdo reforme është proces i vështirë i cili kërkon shumë punë, përkushtim, megjithatë ne jo vetëm se e kemi të domosdoshme por e kemi edhe si kusht të vetëm që me të vërtetë të bëhemi shtet të cilin e dëshirojnë të gjithë qytetarët. Nuk është më pak e rëndësishme të theksohet se reforma duhet të zbatohet njëkohësisht në fushën e zgjidhjeve personale, pajisjes materiale teknike, ligjeve procesuale, ligjeve materiale, për shkak se çdo qasje ndryshe ndaj reformës nuk do të jetë reformë.





Projekti është financuar nga
Bashkimi Evropian

Partnership Justitia: Regaining Citizens' Trust
Партнерство Јустисија: Враќање на довербата на граѓаните
Partneriteti Justitia: Rikthimi i besimit të qytetarëve



Projekti është bashkëfinancuar
nga Qeveria e Republikës së
Maqedonisë së Veriut